

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7822 E shtunë 16 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**

Debati mbi dialogun me Serbinë ende vazhdon të jetë i mbushur me emociione e iluzione e nuk po merr trajtimin e duhur realist që do duhej të merrte. Fatkeqësisht...

Vijon në faqen 20

Nga ADRI NURELLARI

Debati për dialogun, ende midis reales dhe ideale



Opinion **Ditës**

Sot opozita reale e vendit mbledh "kuvendin" e saj. Në rrugë. Përballë Kryeministrisë. Në protestë. Sot të gjithë shqiptarët e mbajnë frymën tek ajo që do të ndodhë përpara...

Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI

Në dorë të popullit opozitar



Kushtet që duhet të plotësojnë maturantët

Universiteti i Tiranës, zbardhen kriteret e pranimit në 6 fakultete

Ja sa do të vlerësohet nota mesatare aritmetike e provimeve të Maturës Shtetërore

Nga VOLTIZA DURO

Brenda pak muajsh do të zhvillohen provimet e Maturës Shtetërore për mijëra maturantë në mbarë vendin, çka do të hapë rrugëtimin akademik për ata që plotësojnë kriteret e përcaktuara nga vetë universitetet...

Në faqet 8-9

OPOZITA PROTESTON SOT PARA KRYEMINISTRISË, KRYEMADHI: RAMA NE IKJE

BASHA: SOT, TAKIM ME HISTORINE. RAMA: VAZHDOJME DERI ME 2021

PD-LSI organizojnë tubimin para zyrës së kryeministrit, ja masat ekstreme të marra nga policia. Deputeti gjerman: Edhe qeveria mban përgjegjësi



(Në foto) Kryeministri Edi Rama, dje në Berat. Protesta e opozitës para Kryeministrisë, më 16 shkurt

REAGIMI I AMBASADES
SHBA: Protesta e opozitës, tregoni vetëpërmbajtje, dhuna e paligjshme

Në faqen 4

ZELANDE E RE
Terrorizmi anti-islam, vriten 49 besimtarë brenda në xhami

Në faqen 7

FATURA FINANCIARE
Pronat, 6 mijë dosjet që iu është njohur e drejta për kompensim

Në faqet 10-11

MESAZHI I SHKRIMTARIT
Letra publike e Kim Mehmetit: Vlerat e rralla janë si shkëmbinjë

Në faqen 12

"BLUETOOTH"



INTERVISTA

Rikthehet Bledi Strakosha, një 'reality show' për të njohur VIP-at

Suplement

Deputeti më i ri i LSI-së rezulton i dënuar për kontrabandë dhe falsifikim

Zbulohet dënimi, Ylli Shehu rrezikon mandatin

Futi 'BMW' me dokumente të rreme zhdoganimi. Reagimi: S'kam gjë për të fshehur

Ylli Shehu, deputeti i ri nga listat e LSI-së, i cili u betua në Kuvend më 4 mars, ka fshehur në formularin e deklarimit të depozituar në KQZ, një dënim për kontrabandë, falsifikim të dokumenteve dhe falsifikim të vulave, stampave ose formularëve. Vendimi për dënimin



e tij mban datën 18 nëntor 2008 dhe është dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë. "News 24" ka siguruar vendimin e Gjykatës së Korçës, që e gjen fajtor Shehun, i cili si dënim duhej të paguante 600 mijë lekë të rinj, për të tri vepra...

Në faqen 5

PROTESTA E OPOZITËS PËRPLASJA

Kreu i qeverisë ka theksuar se me metoda të tilla qeveria e tij nuk preket

Rama: Qeverisim vendin deri në 2021, opozita ka frikë nga zgjedhjet

"Mbajini burrat nga xhaketa, të mos shkojnë pas Berihait"

Mazhoranca është e vendosur të mos bëjë asnjë hap pas sa i përket plotësimit të kërkesave të opozitës dhe zgjidhjes së ngërçit politik në vend. Nga Berati ku vijoi turin e tij të takimeve "Bashkia që duam", kryeministri Edi Rama sfidoi opozitën, duke theksuar se do të qeverisë deri në fund të mandatit që i ka dhënë populli. "Detyra jonë është t'i qëndrojmë besnikë kontratës që kemi me shumicën e shqiptarëve, që na dhanë mandatin për të qeverisur punët e vendit deri në vitin 2021. Këto teoritë që ne po i djegim dhe po ikim nga stadiumi fare dhe po ju lëmë juve në fushë vetëm, kështu që dilni të gjithë nga stadiumi, të fillojmë ndeshjen nga e para, por tani do e caktojmë ne se kush futet në fushë e kush nuk futet në fushë, janë muhabete që as në kafenë e fshatit nuk i bëjnë burrat", - u shpreh kryeministri Edi Rama në fjalën e tij para qindra qytetarëve, që kishin mbushur bulevardin e qytetit në një takim të organizuar edhe në Berat me karriqe të ulura. Më tej ai theksoi se nga i gjithë ky aksion i opozitës qeveria nuk cenohet, pasi mazhoranca është solide, por sipas tij, nga kjo situatë preket vendi. "Një gjë është e sigurt, me metoda të tilla e vetmja gjë që nuk preket është qeveria. Kjo punë nuk ka asnjë shans të mbarojë me prekjen e një fijeje floku të shumicës qeverisëse. Nuk preket dot, përkundrazi! Po të ishte për qeverinë dhe për shumicën në parlament, as nuk do i hynim fare këtij diskutimi, as nuk do t'i përmendim fare këto rrezeqe, por ka gjëra të tjera shumë të rëndësishme që preken. Më e rëndësishmja, preket Shqipëria", - theksoi Rama. Kryeministri u shpreh se protestat dhe vendimi për djegjen e mandateve burojnë pikërisht nga frika që ka opozita se në zgjedhjet e ardhshme vendore humbet sërisht. "Pse e bëjnë? E bëjnë



Kryeministri Edi Rama, dje në Berat

PROTESTA

"Nuk ka çfarë bëhet fare andej, po mbajini burrat këtu se sido që të vijë puna, ju e keni në dorë. Edhe shtëpinë, edhe ekonominë edhe të gjitha, lerë se çfarë thonë. Dhe kur vjen puna, mes burrave, burrat socialistë edhe bëjnë ndonjë punë. Burrat demokratë vetëm për punë nuk i ke", - theksoi kryeministri.

PS s'pranon mandatet e opozitës, Balla: Devijohet vullneti i votuesve

Mazhoranca e majtë nuk do ta vijojë më tej procedurën për plotësimin e të gjitha vendeve në Kuvendin e Shqipërisë. Socialistët do të ndjekin procesin deri në ezaurimin e të gjithë listës së kandidatëve të Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe më pas do ta ndalojnë procesin e plotësimit të vakancave që mbetën në Kuvend. Këtë e konfirmon kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, i cili bën të ditur se vet PS nuk do të pranojë të marrë asnjë mandat që mbetet i pa plotësuar si pasojë e shterimit të listave të PD dhe LSI. Kjo sipas tij do të e papranueshme, pasi në këtë rast do të kishin një devijim të vullnetit të qytetarëve. "Kodi flet vetëm për rastet e shterimit të listës brenda koalicionit, Kodi nuk ka parashikuar



kur shteron lista në rastet kur partitë garojnë të vetme. Do të ishte e pakuptimtë që mandatat e një partie të shkojnë tek një parti tjetër: Nuk ka rendësi se të kush", - thotë Balla. Në fakt çështja është bërë problematike, pasi në Qarkun e Kukësit ka përfunduar lista e kandidatëve të PD-së dhe mandati i dytë i kësaj force në këtë qark do mbetet i papërfunduar. Vetë Kodi Zgjedhor parashikon zgjidhje vetëm kur partitë janë në koalicion, por jo kur ato kanë kandiduar veçmas. Në lidhje me apelin e ndërkombëtarëve për di-

alog mes mazhorancës dhe opozitës, Balla u shpreh se PS është e gatshme të dialogojë, por pa cenuar parimet e demokracisë. "Dialog, kur të duan, si ta dua. Por negociata mbi parimet demokratike nuk ka. Pra, negociata që shkelin Kushtetutën, negociata që shkelin funksionalitetin demokratik të vendit, nuk ka", - u shpreh Balla. Kryetari i grupit të PS-së u shpreh gjithashtu se mazhoranca do të dialogojë me opozitën, që ndodhet në parlament për të miratuar reformën zgjedhore.

se ja, më thoni ju mua tani, çfarë do bëjnë në Berat ata në qershor? Do bashkohen bashkë? Do vijnë këtu? E çfarë do bëjnë? Thjesht do dorëzojnë bashkinë e Beratit dhe mbajeni mend çfarë po ju them. Do dorëzojnë Bashkinë e Beratit. Do dorëzojnë

Bashkinë e Kuçovës. Do dorëzojnë Bashkinë e Skraparit. Të tria. Do t'i dorëzojnë paqesisht. Tani, "jo, po ne nuk hymë në zgjedhje". Unë them që do hynë, por po nuk hynë, ç'problem ka? Ne i kemi ndarë gjërat. Luli me Monikën, Monika me Lulin. Ne me

njerëzit, njerëzit me ne", - tha kryeministri Edi Rama. Më tej, ai u shpreh se beteja e madhe e qeverisë nuk është me opozitën, për të cilën ai u shpreh i bindur se mund ta mundë sërisht në zgjedhje, por është papunësia, korrupsioni dhe problemet në ad-



Protesta e opozitës para Kryeministrit, më 16 shkurt

Veliaj, kandidat i PS për Tiranën: Mezi pres të mësoj kundërshtarin

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, ndonëse nuk është konfirmuar zyrtarisht nga strukturat vendimmarrëse partiake, e konsideron vetën zyrtarisht kandidat për një mandat të dytë për Tiranën. Duke folur për "A2", ai u shpreh se mezi pret që të njohë edhe kundërshtarët e tij në garën për Bashkinë e Tiranës. "Mezi e pres, një dy disa, se duke pasur një debat, do të kemi edhe diskutime se kush mund ta bëjë më mirë këtë punë", - tha Veliaj. Ndërkohë që ai ka ironizuar protestën që do të mbajë sot opozita, duke theksuar se ndër të tjera ajo e ka edhe një anë pozitive, pasi do sjellë shumë njerëz nga rrethet që mund të shpenzojnë lekë në të mirë të ekonomisë së qytetit. "Një mundësi e mirë për turizmin e kryeqytetit, mezi e pres sepse vijmë shumë njerëz dhe shpenzojnë lekë që i japin deputetët dhe zhvillojnë ekonominë e qytetit tonë", - tha Veliaj.



ministratë. "Ne betejam me ta i kemi fituar dhe do t'i fitojmë sa herë do ketë një betejë, por kjo është pjesa më e thjeshtë, ne betejën e kemi me hallet e problemet e njerëzve, betejën e kemi me plagët e ndë të pambyllura të një të shkuare të gjatë dhe të dhimbshme", - theksoi kreu i qeverisë. Ai gjithsesi pranoi se vendi për shkak të qëndrimit që po mban opozita gjendet në një situatë politike absurde. Ndaj ai përmes notave të humorit u bëri thirrje grave të Beratit që të mos i lejojnë burrat e tyre të vijnë sot në Tiranë dhe të protestojnë, pasi kështu i shërbejnë opozitës në dëm të interesit

të vendit. "Unë u them të gjitha grave që i kanë burrat demokratë, mbajini nga xhaketa, mos i lini të shkojnë pas Berihait se sebeb duan që të marrin rrugën të ikin në Tiranë, se rrinë që rrinë në kafe, thonë po ikim, por dalim njëherë andej të shohim ca bëhet". Nuk ka çfarë bëhet fare andej, po mbajini burrat këtu se sido që të vijë puna, ju e keni në dorë. Edhe shtëpinë, edhe ekonominë edhe të gjitha, lerë se çfarë thonë. Dhe kur vjen puna, mes burrave, burrat socialistë edhe bëjnë ndonjë punë. Burrat demokratë vetëm për punë nuk i ke", - theksoi kryeministri.



Valentina Madani

Opozita do të zbrësë sot sërisht në shesh për të kërkuar largimin e qeverisë "Rama" dhe krijimin e një qeverie tranzitore. Pas një muaj protestash para Kuvendit dhe në qytete të ndryshme të vendit, mbështetësit e opozitës do të përipiqen të tregojnë forcën se shumica janë ata. Protesta e sotme përpara Kryeministrisë do të ketë vetëm marshim të qytetarëve dhe nuk është parashikuar asnjë fjalim nga ana e liderëve. Një protestë e ngjashme me atë 16 shkurtit përpara Kryeministrisë. Por, mësohet se ajo nuk ka ndonjë orar se kur do të përfundojë. Si në protestën e 16 shkurtit, edhe më 16 mars, kryetari i PD-së Lulzim Basha, kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi drejtues dhe funksionarë të tjerë të PD-së do të jenë në shesh vetëm në rolin e dëgjuesve, ndërsa fjalën do ta kenë qytetarët. Kjo është hera e parë kur funksionarët e opozitës do të jenë në shesh pa mandate, duke mos i siguruar atyre asnjë mbrojtje ligjore. Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku, paralajmëroi dje se do të jetë një protestë madhështore me forcën e numrave, pa fjalime dhe që do të zgjasë disa orë. "Më 16 mars do vijmë qytetarë nga Shqipëria, do protestojmë para Kryeministrisë për të treguar se qeveria nuk përfaqëson situatën politike dhe ekonomike, nuk përfaqëson asgjë që ka lidhje me interesin e shqiptarëve. Do ketë prezencë të diasporës dhe ka domethënie shumë të madhe se një nga arsyt pse largohen shqiptarët është Edi Rama dhe qeveria e tij. Protesta do të nisë në orën 11:00 dhe do mbarojë kur të shikohet e arsyeshme se mbaron. Nuk do jetë 1 orë ose dy orë, nuk do ketë fjalime", - tha zj. Tabaku. Opozita ka angazhuar strukturat e saj, me qëllim për të pasur sa më shumë protestues përpara Kryeministrisë. Lulzim Basha zhvilloi një tur takimesh jashtë Tiranës, ndërkohë që ka mbledhur disa herë strukturat e PD-së, me qëllim për të pasur sa më shumë masivitet më 16 mars, ndërkohë që mbrëmë mboldhi aleatët në selinë e PD-së për detajet e fundit të protestës.

SIGURIA

Kryeministria nga ana e saj ka marrë masat duke vendosur skela siguri. Po ashtu, për të vëzhguar protestuesit janë instaluar 4 kamera me shikim 360 gradë. Ato janë pozicionuar dy me pamje nga godina e qeverisë dhe dy nga Kuvendi. Përforcimi i skelës pranë hyrjes së Kryeministrisë ka nisur që prej mëngjesit, ndërsa ndryshe nga protestat e tjera është zgjeruar edhe perimetri rrethues me kangjella. Përveç këtyre masave, Policia e Shtetit ka instaluar dhe 4 kamera sigurie para godinës së Kryeministrisë, të cilat do të shër-

Kreu i PD-së, përgjigje ambasadës së SHBA-ve: Mos u bëni palë me asnjë parti

Rrethohet Kryeministria, Basha: Protesta sot do të hyjë në histori

"Deputetët e rinj u shitën si gjëja e gjallë"



Kryemadhi: Të gjithë në shesh, Rama do ikë bashkë me brekushet e veta

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi replikoi dje në distancë me kryeministrin Edi Rama, ku ky i fundit ironizoi me thirrjet që Kryemadhi ka bërë ndaj Zotit për të ruajtur shqiptarët nga fenomeni i blerjes së votës. Teksa ftoi kamzalinjtë për protestën e 16 marsit, Kryemadhi tha se tani është koha që Edi Rama të largohet andej nga ka ardhur së bashku me 'brekushet' që mban veshur, duke shtuar se tubimi i nesërëm do të jetë madhështor. "Do të lutem në Zot për të ngritur besimin dhe paqen tek njerëzit. Do të lutemi në Zot që të na shpëtojë fëmijët nga droga, krimi, varfëria, injoranca dhe nga intimidimi i grupeve kriminale. Do të lutemi në Zot për flamurin kombëtar që të valëvitet krenar. Laje gojën tënde të ndyrë që ke guxuar të ofendosh gratë dhe vajzat shqiptare. Nesër të gjithë në shesh, për të ardhmen tonë, sepse Shqipëria është shtëpia e djemve e vajzave tona. Ne do të ndërtojmë të ardhmen tonë këtu në Shqipëri. Nesër do të jetë një nga protestat që nuk e ka parë ndonjëherë Shqipëria. Le të ikë Edi Rama me brekushet e veta andej nga ka ardhur. Ne do ta bëjmë Shqipërinë evropiane, sepse në zemrat tona ka dëshirë dhe dashamirësi për vendin", tha Kryemadhi.



REVOLTA

"Tashmë ka kapërcyer momenti që protesta të ketë nevojë për koreografi. Ne po i kthehemi revoltës, jemi në pragun e revoltës. Jemi një popull evropian dhe nuk e meritojmë ta kemi opozitën jashtë Kuvendit, ky duhet të marrë fund. Populli duhet të vijë të përballlet me të keqen", - tha Kadilli, në "News 24".

aktorët të tregojnë vetëpërmbytje dhe të shmangin dhunën.

Basha nga ana e tij shprehet se nuk do të komentojë deklaratën e tyre, por ai kërkon që ata të mos bëhen palë me asnjë person apo parti politike. Këto deklaratë kreu i PD-së i bëri pas takimit me ministrin e Jashtëm çek. "Nuk komentoj deklaratat e ambasadave meqë më pyesni. Nuk i kërkoj të jenë palë me asnjë person në Shqipëri, me asnjë parti politike, por i kërkoj të jenë palë për vlerat me të cilat vendet e tyre qëndrojnë, vlerat e demokracisë, të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, të luftës kundër korrupsionit, të luftës kundër krimit të organizuar dhe drogës, të luftës kundër shitblerjes së votës. Probleme të cilat i shprehu qartë edhe Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit para ditësh. Protesta e nesërme (sotme) do të jetë një tjetër rast për shqiptarët për t'u bashkuar dhe për të ngritur zërin. Shqiptarët tashmë e kanë kuptuar që e vetmja mënyrë për të garantuar ndarjen e së keqes, është protesta", - theksoi z. Basha.



Nga Londra në protestë, Hasani: PD duhet të vijë në pushtet

Në protestën e sotme të opozitës do të marrin pjesë edhe përfaqësues nga diaspora. Kreu i PD-së në Londër, Naim Hasani është njëri prej tyre, i cili në studion e "News 24" dje deklaroi se ka ardhur enkas për këtë protestë. "Vij nga Anglia për protestën, nesër Shqipëria do ndahet nga vjedhja, mashtrimi dhe manipulimi. Do ta bëjmë zërin tonë të dëgjohet fuqishëm në mënyrë paqësore", - tha ai. Sipas tij, ka ardhur koha që shqiptarët të mos i përfaqësojnë më në parlament njerëz të lidhur me krimin dhe që ulen aty falë votave të blera. Ardhjen e PD-së në pushtet e sheh si të vetmen mundësi, që siç tha, politika të ndahet nga krimi. "Ardhja e PD në pushtet për një arsye madhore, që politika në Shqipëri të ndahet nga krimi", - u shpreh Hasani.

REAGIMI

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, u përcolli dje një mesazh të fortë ndërkombëtarëve teksa iu kërkoj të mos jenë palë me asnjë parti politike në Shqipëri, por me vlerat e demokracisë. Ambasada e SHBA-ve apeloj që gjatë protestës së sotme opozitarë të gjithë

Kreu i PD, Lulzim Basha vijoi dhe takimin e radhës me studentët dhe pedagogët të Universitetit të Durrësit, të cilët i ftoi të marrin pjesë në protestën e 16 marsit. Ai përmendi se protesta e studentëve sollë më herën pranverën, ndërsa komentoj edhe vendimin e disa deputetëve në listat e opozitës që pranuan të marrin mandatin e deputetit si dhe të atyre që refuzuan ta dëgjin. Basha u shpreh se deputetët e rinj u shitën dhe blenë nga qeveria si të ishin bagëti në tregun e Milotit. "Shikoni si i trajton deputetët, si bagëti që shiten e blihen si në pazar të Milotit. A ka shenjë më të qartë të degradimit të këtij pushteti, sesa shitblerja, e të ashtuquajturve deputetëve të opozitës së re si të ishin bagëti. Protesta e studentëve sollë më herën pranverën dhe i parapriu këtij zgjim kombëtar dhe bashkimit të shqiptarëve që kanë marrë tashmë vendimin. Zot në shtëpinë e Shqiptarëve nuk do jenë më kriminelët, por do jenë vetë shqiptarët. Rama u kap në flagrancë duke vjedhur vota, ndërsa Vangjush Dako e ka vendin në burg. Dako u pasurua në kurriz të qytetarëve", - tha z. Basha.

Mandatet, Berisha-ndërkombëtarëve: Cunami i 16 marsit do mahnitë botën

Ish-kryeministri Sali Berisha reagoi dje pas kritikave të ndërkombëtarëve për aktin e djegies së mandateve nga opozita. Berisha shprehet se e kupton qëndrimin e tyre që nuk mbështetën djegien e mandateve, por opozita ka mirëkuptim për këto qëndrime dhe po bën gjithçka për të qartësuar shkaqet që detyruan për vendimin e saj. "Së pari, vetëkuptohet se komuniteti zyrtar ndërkombëtar nuk mbështet dhe nuk mund të mbështesë djegien e mandateve. Së dyti, mendoj se opozita ka mirëkuptim për këto qëndrime dhe po bën gjithçka për të qartësuar shkaqet që detyruan opozitën për vendimin e saj. Së treti, sot opozita dhe shqiptarët në tërësi me protestën dhe kauzën e tyre kanë fituar me shpejtësi të rrafshme pushtetin e katërt botëror. Mediat e botës kanë paraqitur revolucionin e shqiptarëve si ngjarje botërore, në qindra e qindra lajme kanë informuar publikun e tyre se opozita shqiptare proteston kundër lidhjeve të qeverisë së Edvinut me krimin, korrupsionin e papërmbyjtur dhe dhunimin e zgjedhjeve, dosjet famoze të prokurorisë, proteston kundër narkoshtetit dhe kontrollit të Shqipërisë, tashmë Kolumbi e Europës nga mafia", shprehet z. Berisha. Sipas tij, "protesta historike e opozitës nëpërmjet mediave të mëdha po fiton mendjen dhe zemrën e komunitetit ndërkombëtar dhe ka damkosur narkoshtetin e regjimit të kaksistokracisë. Revolucionin i pandalshëm po ecën drejt fitores! Cunami i datës 16 mars do mahnitë botën!".

KRIZA POLITIKE NDERKOMBETARET

BE kërkon zgjidhje urgjente të situatës: Dialog ndërmjet të gjitha palëve

Valentina Madani

SHBA dhe BE: Nxitja e dhunës në protesta, e patolerueshme

"Qeveria e parlamenti njihen ndërkombëtarisht"

Ndërkombëtarët kërkojnë shmagje të dhunës në protestën e sotme të opozitës, çdo formë e të cilës konsiderohet e paligjshme. Ambasada Amerikane bën thirrje për mos nxitje të dhunës dhe shkatërrim të pronës publike ndërsa BE kërkon zgjidhje urgjente të situatës së tensionuar në vend. Sipas ambasadës qeveria dhe parlamenti aktual i Shqipërisë janë legjitimë dhe të njohura ndërkombëtarisht dhe nxisin aktorët të ushtrojnë vetëpërmbytje në protestën e 16 marsit. "Pavarësisht se protesta paqësore është një shtyllë themelore e demokracisë, nxitja apo kryerja e veprimeve të dhunshme, përfshirë edhe shkatërrimin e pronës publike, janë të paligjshme. Ne i nxisim të gjithë aktorët e demokracisë shqiptare që të ushtrojnë vetëpërmbytje në protestën e 16 marsit. Ambasada e Shteteve të Bashkuara i konsideron qeverinë dhe parlamentin aktual të Shqipërisë të zgjedhura në mënyrë legjitime nëpërmjet zgjedhjeve të vitit 2017, të njohura ndërkombëtarisht", thuhet në regjimin e ambasadës së SHBA. Madje ambasada amerikane i kërkon deputetëve që vendosën të braktisin mandatin të lejojnë ata që duan të punojnë për të ardhmen e vendit të bëjnë punën e tyre. "Ne vlerësojmë punën e mirë që është bërë në zbatimin e reformës në drejtësi në Shqipëri, si dhe përparimin në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ka ende punë për të bërë. Ndërkohë që, ata ish-anëtarët të parlamentit të cilët vendosën të braktisin mandatin, hoqën dorë nga detyrimet e tyre ndaj qytetarëve shqiptarë, duhet të lejojnë ata që duan të punojnë për të ardhmen e vendit të bëjnë punën e tyre. Ne mbështesim të gjithë ata që vazhdojnë të jenë të përfshirë në procesin demokratik në parlament, në mënyrë që Shqipëria të vazhdojë të ecë përpara, drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian", thuhet në regjimin e ambasadës së SHBA-ve në Tiranë.

shirë reformimin e kuadrit ligjor zgjedhor në përputhje me rekomandimet e OSBE / ODHIR-it", thuhet në regjimin e delegacionit të BE-së në Tiranë. BE konsideron si të drejtë themelore protestat qytetare, por ato nuk duhet të jenë të dhunshme. "Kjo e drejtë është një shtyllë qendrore në çdo shoqëri demokratike, por duhet ushtruar në mënyrë paqësore, pa përdorur dhunën. Asnjë formë e nxitjes së dhunës nuk është e tolerueshme. Ne u bëjmë thirrje edhe një herë të gjithë liderëve të partive që të tregojnë përgjegjësi për të shmangur çdo përshkallëzim gjatë protestave", citohet deklarata e BE-së. Dorë-



Ambasada e SHBA-ve në Tiranë

imin e mandateve nga opozita, BE e konsideron si pengesë për funksionimin e demokracisë duke ndikuar në integrimin e vendit. "Astu siç kemi deklaruar edhe më parë, konsiderojmë se vendimi për heqjen dorë nga

mandatet parlamentare pengon seriozisht funksionimin e demokracisë në Shqipëri dhe ndikon në integrimin e vendit në BE - një perspektivë që e duan plotësisht 93% e qytetarëve shqiptarë. Ne vazhdojmë të mbështesim ata që janë të angazhuar në procesin demokratik në Parlament, gjithashtu, në mbrojtjen e interesave të popullsisë shqiptare që dëshiron të vazhdojë të ecë drejt BE-së. Që prej qershorit të kaluar është bërë progres, veçanërisht në reformën në drejtësi, si dhe në luftën kundër krimit të organizuar, por ka ende shumë punë për të bërë në tre muajt e ardhshëm", thuhet në regjimin e BE-së.



Azerbajxhan, Meta nderohet me Titullin "Doctor Honoris Causa"

Gjatë vizitës në Azerbajxhan, Presidenti i Republikës, Ilir Meta, u nderua me Titullin "Doctor Honoris Causa" nga Akademia e Administratës Publike të Azerbajxhanit. Në emër të Akademisë dhe në praninë të profesorëve e studentëve të Akademisë, Presidenti Meta ia dorëzoi titullin. Rektori i saj Dr. Urkhan Kazim oglu Alekperov. Në fjalën e tij, Rektori Alekperov, vlerësoi rolin e veçantë të Presidentit Meta në forcimin e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Azerbajxhanit. Ndërsa, Presidenti Meta e konsideroi titullin si shenjë mirënjohje dhe vlerësimi ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve dhe reflektim të marrëdhënieve të shkëlqyera midis dy vendeve. Në mënyrë të veçantë, Presidenti Meta vlerësoi se në dekadën e fundit marrëdhëniet midis dy vendeve janë intensifikuar shumë dhe realizimi i projektit TAP i ka dhënë mundësi e dimensione të reja këtij bashkëpunimi. Gjithashtu, Presidenti Meta nënvizoi se përtej marrëdhënieve ekonomike, një vëmendje më e madhe i duhet kushtuar shkëmbimeve kulturore dhe eksperiencave akademike midis dy vendeve. "Nxitja e bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimit dhe të kulturës dhe kontakteve të drejtpërdrejta mes studentëve, akademikëve e qytetarëve të të dy vendeve është investimi më i madh e afatgjatë", theksoi Presidenti Meta.

Deputeti gjerman Schmidt: Edhe qeveria mban përgjegjësi

CDU, Henze: PD-së iu asgjësua çdo liri në Kuvend, duhen zgjidhje të reja



drejtë. Në Shqipëri s'ka gjykate kushtetuese dhe gjykate të lartë. Kjo do të thotë që opozita nuk ka asnjë të drejtë për të kontrolluar parlamentin ose për të apeluar vendimet e parlamentit. Gjykata Kushtetuese mungon e për këtë arsye mungon e drejta parlamentare. Ndaj vendimi i

MARTIN HENZE
Zyrtari i CDU-së, i cili vjen në Tiranë për të parë nga afër protestën e opozitës, shprehet se zgjidhja e kësaj situatë mund të jetë vetëm zgjedhje të reja.

force politike e zgjedh vetë rrugën e saj. Në Evropë ka mendime kontraktore për vendimin e PS-së, për djegjen e mandateve. Pra, jo çdo gjë që vjen në Shqipëri, se Evropa kritikon PD-në është e vërtetë. Ka mendime të ndryshme", tha z.Henze. Zyrtari i CDU-së, i cili vjen në Tiranë për të parë nga afër protestën e opozitës, shprehet se zgjidhja e kësaj situatë mund të jetë vetëm zgjedhje të reja. "Duhet të dy palët të tregojnë përgjegjësi dhe të arrijnë në një përfundim që mund të jenë edhe zgjedhjet", theksoi z.Henze. I pyetur për aktet e dhunës në tubimet e kaluara, Henze, tha se ato nuk e cenojnë të drejtën demokratike për të protestuar.

SHPLLJE ANKANDI
Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me Përmbarues Gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap. 1, Tiranë, njofton se më datë 08.04.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankand i liri për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Apartament me sipërfaqe totale 45.3 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 5629+1-26, Vol.13, Fq.41, Zk.3976 në pronësi të Hipotekës së shoq. Sina Konstruksion 2008 sh.p.k me adresë Skoçëz, Tiranë me vlerë fillestare në ankan 9.132.48 (Nëntë mijë e nëqind e tridhjetë e dy pikë dyzet e tetë) EURO dhe Apartament me sipërfaqe totale 63.3 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 5629+1-26, Vol.13, Fq.42, Zk.3976 në pronësi të Hipotekës së shoq. Sina Konstruksion 2008 sh.p.k me adresë Skoçëz, Tiranë me vlerë fillestare në ankan 12.761.28 (Dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë njëzet e tetë) Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

SHPLLJE ANKANDI
Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me Përmbarues Gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruova, Pallat 64, Hyrja 8, Ap. 1, Tiranë, njofton se më datë 02.04.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankand i liri për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Apartament me sipërfaqe 50 m² regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 5194/1+1-0, Volumn 7, Fq. 177, Zona K. adastrale 220 në pronësi të debitorit Z.Arjan Xhevat Gjonaj me vlerë fillestare në ankan 100.000 (njëqind mijë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com.

Dekriminalizimi/ Deputeti i LSI, i dënua për kontrabandë dhe falsifikim

Ylli Shehu, deputeti i ri nga listat e LSI-së, i cili u betua në Kuvend më 4 mars, ka fshehur në formularin e dekriminalizimit të depozituar në KQZ, një dënim për kontrabandë, falsifikim të dokumenteve dhe falsifikim të vulave, stampave ose formularëve. Vendimi për dënimin e tij mban datën 18 nëntor 2008 dhe është dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë. "News 24" ka siguruar vendimin e Gjykatës së Korçës, që e gjen fajtor Shehun, i cili si dënim duhet të paguante 600 mijë lekë të rinj, për të tri vepra penale. Në vendim thuhet se Shehu kishte futur në Shqipëri në muajt tetor-nëntor 2003 një automjet "BMW X5", pa paguar detyrimin e saktë doganor dhe kishte dashur ta targonte duke paraqitur në Degen e Doganës, Korçë, dokumente të rreme zhdoganimi. Gjykata vlerësoi se nëpërmjet këtij veprimi, Ylli Shehu kishte mundur të shmangej nga detyrimin doganor në shumën 1.110.109 lekë, duke paguar vetëm 154.421 lekë. Gjykata e Korçës parashtron se dokumentet e paraqitura kishin bërë të mundur që Ylli Shehu të merre deklaratën doganore dhe më pas këtë deklaratë ta ndryshonte në përmbajtje, në vula, shkrime e nënshkrime të Doganës Korçë. Më pas, këtë deklaratë së bashku me dokumentet e tjera të mjetit "BMW X5", i kishte dorëzuar

Fshehu dënimin në vitin 2008, Ylli Shehu e "humb" mandatin Futi 'BMW' me dokumente të rreme zhdoganimi



Ylli Shehu, deputeti i LSI-së

YLLI SHEHU: S'KAM GJË PËR TË FSHEHUR

"Edhe nëse ky rast do të përbëjë arsye për një rikontroll, shpreh gatishmërinë time për të bashkëpunuar me çdo institucion ligjzbatues para të cilëve asgjë s'kam për të fshehur. I gjithë ky sulm bëhet për të dekurajuar kolegët dhe koleget e tjera që janë në proces të marrjes së mandatit. Unë jam shumë i qetë dhe i përgjeshëm për detyrën që kam".

në Drejtorinë Rajonale të Transportit Rrugor Tiranë, ku kishte bërë edhe targimin. Pas këtyre veprimeve, Shehu kishte shiur mjetin në 11 shkurt 2004. Sipas dokumenteve, avokati mbrojtës, Robert

Hysa, gjatë procesit kishte pohuar se i pandehuri Ylli Shehu i pranonte akuzat dhe se ndihje i penduar: Madje, kishte kërkuar edhe masa lehtësuese për arsye se i mbrojturi prej tij ishte pa precedentë

penalë, në kushte të vështira ekonomike e familjare. Në fund të gjykimit gjykata kish vendosur dënimin me 200 mijë lekë të rinj për secilën veprë penale ndaj Ylli Shehut. Ky dënim i nëntorit 2008 është fshehur në deklaratën e dekriminalizimit, detyrim ligjor për çdo zyrtar të lartë të zgjedhur. Në formular, Ylli Shehu ka përmendur vetëm dënimin e marrë në 20 mars 2007, nga Gjykata e Tiranës, po për kontrabandë dhe ku dënohej me gjobë në 200 mijë lekë të rinj. Por edhe këtë vendim, menjëherë pas miratimit të ligjit për dekriminalizimin në Kuvend në vitin 2015, Shehu e kishte fshehur. Por që bëri plotësimet e nevojshme pak më vonë, e për pasojë nuk u mor asnjë vendim për ndërprerjen e mandatit. Megjithatë, mandatin e deputetit e mori dhe sot është anëtar i Kuvendit të Shqipërisë.

SHKURTE

Tiranë, kapet grupi i drogave të forta

Pas një hetimi me metoda speciale policia e Tiranës mundi të finalizojë operacionin policor të koduar "Lapra" në fushën e tregëtimit të lëndëve narkotike, gjatë të cilit u kapën dhe arrestuan në flagrancë 3 persona: A. D., 25 vjeç, banues në Tiranë; A. K., 45 vjeç, banues në Tiranë (i dënua më parë për vjedhje me armë, me pasojë vdekjen) F. Q., 34 vjeç, banues në Tiranë. Shtetasit e mësipërm kanë qenë në vëzhgim dhe ndjekur nga shërbimet e Antidrogës në funksion të procedimit penal të regjistruar të ndjekur me metoda speciale hetimi, pasi për ta disponohej informacion se në bashkëpunim me njëri-tjetrin tregëtonin në zona të ndryshme të kryeqytetit dhe ambiente shkollimi droga të forta në formë dozash.

Makina bie në kanal, vdes 17-vjeçarja

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur dje në vendin e qajtur mbi Shkallë, në Borsh. Raportohet për një aksident ku ka humbur jetën një 17-vjeçarë e identifikuar si Analuiza Duro. Burime të "Balkanëb" bëjnë me dije se vajza e re ishte pasagjere në mjetin që drejtohej nga shtetasi R.Dh., 19 vjeç. Makina tip "Audi" ka humbur kontrollin duke rënë në një kanal kullues në plazhin e Borshit.

Mundësi punësimi në Ambasadën e Japonisë në Shqipëri: Mazhordom dhe Punëtores shtëpie

Ambasada e Japonisë po kërkon punonjës të aftë.

Vendi i punës:

Rezidenca e Ambasadorit të Japonisë në Tiranë

Data e fillimit të punës:

E pa përcaktuar ende. (Midis fund prilli dhe majit, 2019)

Vendet e lira:

Mazhordom dhe Punëtores shtëpie - 2 (dy) vende

Paga:

Do të vendoset në varësi të përvojës dhe aftësive. Kandidati i suksesshëm do të gëzojë kushtet e punësimit në përputhje me ligjin shqiptar/japonez, duke përfshirë edhe regjistrimin në skemën e sigurimeve shëndetësore e shoqërore.

Periudha e pritshme e punës:

E papërcaktuar. Do t'i nënshtrohet periudhës së provës gjatë 3-mujorit të parë të punësimit.

1. Detyrat

Detyrat kryesore do të jenë si më poshtë:

- Mirëmbajtja e rezidencës së Ambasadorit (Pastrimi, Lavanderia dhe Hekurosja, etj.).
- Të ndihmojë gjatë drekave, darkave dhe pritjeve zyrtare në rezidencë.
- Menaxhimi i produkteve ushqimore, pajisjeve të kuzhinës dhe mallrave të ndryshme.
- Detyra të tjera të caktuara nga Ambasada.

2. Kriteret

Kandidati i suksesshëm duhet të zotërojë aftësitë dhe cilësitë kyçe të mëposhtme:

- Të zotërojnë rrjedhshëm gjuhën Shqipe dhe aftësi të mira komunikuese në Anglisht. Të ketë përvojë pune në ndonjë mjedis anglishtfolës është gjithashtu e dëshirueshme.
- Kandidatët që kanë aftësi në gjuhën japoneze do të vlerësohen (kjo jo e detyrueshme).
- Preferohet të ketë aftësi të përgjithshme të përdorimit të kompjuterit (p.sh. Microsoft Office, etj.).
- Përvojë të mëparshme pune në fusha si ajo e shërbimit do të vlerësohet shumë. (p.sh. Hotel, Restorant apo Kompani pastrimi, etj.)
- Të ketë shtetësi shqiptare ose leje qëndrimi të përhershëm në Shqipëri.

3. Si të aplikoni

Për të aplikuar për pozicionin, ju lutemi sillni dorazi (ose me postë) një letër interesi së bashku me CV tuaj në gjuhën angleze, si dhe kopjen e diplomës suaj të fundit në adresën e mëposhtme deri më 1 prill 2019.

Të gjitha dokumentet duhet të mbyllen në një zarf me mbishkrimin "Aplikim për Punë" të shkruar në pjesën e përparme në ngjyrë të kuqe.

Do të merren në konsideratë edhe kopje të certifikatave të aftësisë gjuhësore (TOEIC, IELTS etj.).

-Adresa-

Rruga e Kavajës, Nd50, H1, Kodi postar 1023, Tiranë, Shqipëri ose
-Kutia postare-
P. O. Kutia 1744, Kodi postar 1016, Tiranë, Shqipëri

4. Përgjdhja

Vetëm kandidatët e përgjdhur për intervistë do të kontaktohen nga Ambasada.

CV dhe dokumentet e tjera të dërguara në Ambasadë nuk janë të kthyeshme.

Kandidatët e përgjdhur do t'i nënshtrohen një interviste e cila do të zhvillohet në Ambasadën e Japonisë.



Organization for Security and
Co-operation in Europe
Presence in Albania

INVITATION TO BID No. OSCE PIA/ITB/SALE/2018/01 SALE OF SURPLUS OSCE PRESENCE IN ALBANIA VEHICLES

The OSCE Presence in Albania (OSCE), located at MAK ALBANIA HOTEL, 1st Floor, Sheshi "Italia", 1010, Tirana, Albania intends to sell certain surplus vehicles as described in the Bidding Documents.

A complete set of the Bidding Documents can be obtained upon email request sent at procurement-al@osce.org

Proposals must be delivered to the below specified address on **Friday 5th of April 2019, 13:00hrs** in a sealed envelope and marked as follows:

=====TENDER--DO NOT OPEN=====

Procurement Section

OSCE Presence in Albania, MAKALBANIA HOTEL,
1st floor, Sheshi "Italia", 1010, Tirana, Albania

Subject: Sale of surplus vehicles

Ref: OSCE/ITB/SALE/2019/01

Due date: 5th of April 2019, 13:00hrs (CEST)

Proposals sent by email and facsimile **will NOT be accepted.**

The OSCE reserves the right to accept or reject any Proposal, and to annul, in whole or in part, or to suspend the solicitation process and reject all Proposals at any time and without reason prior to award.



Në ndjekje penale nga KLSH-ja, 122 drejtues institucionesh në prokurori për shkelje e shpërdorime

Nga kryetarë bashkish, te titullarë apo ish-titullarë të Agjencisë së Kthimit të Pronave, hipotekave, zyrate të ALU-IZNI-t, drejtues spitalësh apo entesh, ka arritur në 122 numri i drejtuesve të rangjeve të mesme dhe të larta të kallëzuar penalisht nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për vitin 2018. Në total Kon-

trolli i Lartë i Shtetit ka dërguar në prokurori vitin e shkuar 41 dosje me kallim për indice penale, ku 122 drejtuesit e institucioneve publikë janë vetëm një pjesë e totalit të nëpunësve të dërguar për hetim në prokurori. Por në listë gjenden edhe emrat e titullarëve të institucioneve me rëndësi kyç në jetën e vendit, siç është Kry-

etari i Entit Rregullator të Energjisë, Zëvendësdirigjtor i Përgjithshëm i Tati-meve, apo Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit. Kallëzim penal për vitin e shkuar është bërë edhe për ish-Kreun e Agjencisë së Trajtitimit të Pronave, Drejtori i Portit të Vlorës si dhe disa drejtues spitalësh.



Doganat grumbullojnë 7.6 mln euro më pak se vjet në janar

Plani i të ardhurave buxhetore shfaqi dobësi të theksuar gjatë muajit janar, teksa arkitimet totale shënuan rënie vjetore më së paku 2.4 %, por të dhënat e detajuara tregojnë se rënia është shkakuar tërësisht nga doganat, ku të ardhurat nga TVSH dhe akciza kanë pësuar rënie të ndjeshme në raport me një vit më parë. Sipas të dhënave zyrtare doganat grumbulluan gjatë muajit janar 10.4 miliardë lekë ose 958 milionë lekë (7.6 mln euro) më pak, se një vit më parë. Rënia më të madhe e kanë shënuar arkitimet nga TVSH-ja, të cilat ishin 772 milionë lekë më të ulta se një vit më parë. Vitin e kaluar Ministria e Financave arsyetoi se arkitimet nga doganat sidomos TVSH-ja janë ndikuar negativisht forcimi mbicivimi i monedhës vendase në këmbim me euron. Rezultatet e janarit tregojnë se të ardhurat kanë akciza janë vënë në trend renës. Në janar arkitimet nga ky taksim ranë me 144 milionë lekë në raportin me janarin 2018. Rënie shënuan edhe të ardhurat nga taksa doganore dhe të ardhurat e tjera doganore. Sipas të dhënave zyrtare nga Ministria e Financave gjatë muajit janar janë arkëtuar gjithsej 34.5 miliardë lekë, nga 35.3 miliardë që u grumbulluan në janarin 2018 me një rënie 2.4%. Planin e të ardhurave fiskale e ndikuan për keq edhe arkitimet jo tatimore. Ky grup të ardhurash që përfshin dividendin dhe të ardhura nga institucionet buxhetore shënoi rënie më të madhe me 9.7%. Ndikimin më të madh e dhanë arkitimet buxhetore të cilat ishin 8 milionë euro më të ulta se në janarin 2018 ose 57 për qind më pak. Gjithashtu, u zbehen ritmet e rritjes në të ardhurat nga sigurimet shoqërore. Edhe pse ekonomia dhe punësimi janë rritur me ritme të përsheptuara të ardhurat nga ky zë janë rritur me vetëm 1.6 për qind.

Shkreli: Shqipëria është një vend ku rreth 70% e urave të vendit kanë kaluar moshën 50 deri në 70 vjet

Balluku: Ndërhyrje emergjente sipas studimit teknik

Grupi i punës ka kryer inspektimin e veprave në terren

Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë, Belinda Balluku ka organizuar një tryezë teknike për sigurinë e urave në vend, në të cilin është diskutuar mbi një raport për situatën e urave, të hartuar nga MIE në bashkëpunim me ARRSH dhe Institutin e Ndërtimit. Në tryezë marrin pjesë zv.ministri, Artan Shkreli, i cili ka drejtuar grupin e punës për hartimin e raportit, drejtuesit e ARRSH dhe Institutit të Ndërtimit, grupi i punës që ka kryer inspektimin e urave në terren si dhe ekspertët të kësaj fushe. Në fjalën e saj ministria Balluku theksoi se Ministria e Transporteve dhe Energjisë ka në fokus të saj sigurinë rrugore, ku një vend të rëndësishëm zë edhe vëmendja ndaj gjendjes së urave, të cilat janë pjesë e rrjetit rrugor shqiptar. "Treyza e ka një rëndësi të veçantë, sepse nis një proces, i cili ka të bëjë me identifikimin e problematikës dhe zgjidhjen e saj përmes një skanimit të mirëfillt teknik, siç është në rastin e raportit që ju keni prodhuar, duke i hapur rrugë kështu ARRSH-së apo kujdo institucioni tjetër, i cili bëhet pjesë e zgjidhjes, por mbi një bazë të mirëfillt dhe të mirë studiuar teknike", u shpreh Balluku. Duke ju referuar raportit në fjalë, Balluku vlerësoi gjatë të risitë e tij duke veçuar procesin e plotësimit të pasaportës teknike për çdo urë, hartimi dhe miratimi i një metodologjie për inspektimin, si dhe hartimin e një plani kombëtar të quajtur "Plani i Shpëtimit" i veprave rrugore të artit mbi 50 vite. "Nga ky moment ne nisim një proces, për menaxhimin e urave që janë pjesë e rrjetit rrugor shqiptar. Ky proces duhet të vazhdojë me kontrollin nga ana e ARRSH-së, masat që do të merren, afatet kohore që do të vendosen, rrugët alternative që do të gjenden për urat, të cilat për arsye sigurie nuk do të jenë më funksionale dhe sigurisht për koordinimin e të gjithë institucioneve të tjera, të cilat duhet të jenë pjesë e këtij procesi", u shpreh Balluku, duke garantuar



ARTAN SHKRELI

dy janë faktorët që kanë sjellë dëmtime të urave në vend. "E para ka qenë amortizimi në kohë dhe e dyta ka qenë mungesa e mirëmbajtjes sipas standardeve të përcaktuara", nënvizoi Shkreli. "Shqipëria është një vend ku rreth 70% e urave të vendit kanë kaluar moshën 50 deri në 70 vjet që do të thotë kanë hyrë në fazën e tyre të riskut.

qytetarët se nuk ka nevojë për panik pasi autoritetet përgjegjëse e kanë situatën nën kontroll. Ndërsa zëvendësministri i Transporteve, Artan Shkreli tha se dy janë faktorët që kanë sjellë dëmtime të urave në vend. "E para ka qenë amortizimi në kohë dhe e dyta ka qenë mungesa e mirëmbajtjes sipas standardeve të përcaktuara", nënvizoi Shkreli. "Shqipëria është një vend ku rreth 70% e urave të vendit kanë kaluar moshën 50 deri në 70 vjet që do të thotë kanë hyrë në

fazën e tyre të riskut. Deri tani mirëmbajtja e urave që ka qenë një mirëmbajtje rutinë që do të thotë pastrim, riparim i parrakeve, ndonjë mbushje nga erozioni që është krijuar në këmbët e urave, por asnjëherë ndërhyrje në nivel strukturor, që do të thotë ndërhyrje në elementët konstruktiv të urës, përjashtojt rastet kur ka qenë shumë evident rreziku i shembjes. Ministria me politikën e reja sidomos që kanë të bëjnë me performancën për sigurinë

rrugore do të paraprijë eventualisht problematikave të tilla, nëpërmjet një studimi real duke bërë matjet në vend". Për drejtoreshën e Autoritetit Rrugor Shqiptar, Sonila Qato raporti i inspektimit të urave ka shërbyer për ARRSH-në që fillimisht të marrë masa për shmangien e rrezikut për kalimtarët, të ndërhyjë për të rritur sigurinë dhe pas të vijojë me projektet për rikuperimin e këtyre strukturave. "Ka qenë dhe mbetet në fokus të aktivitetit të Autoritetit Rrugor Shqiptar monitorimi dhe ndërhyrja jo vetëm në ato pika të zeza të identifikuara si burim aksidentesh, por edhe monitorimi i urave në të gjithë territorin. Raporti i inspektimit të urave ka gjenuar pasaportizimin e secilës urë si dhe planet e rehabilitimit përkatës, duke na lejuar si rrjedhojë të marrim masa fillimisht, në shmangien e rrezikut për kalimtarët, rritjen e sigurisë për të vijuar me pas projektet e rikuperimit të këtyre strukturave", u shpreh Qato.

BELINDA BALLUKU

Ministria e Transporteve dhe Energjisë ka në fokus të saj sigurinë rrugore, ku një vend të rëndësishëm zë edhe vëmendja ndaj gjendjes së urave, të cilat janë pjesë e rrjetit rrugor shqiptar. "Treyza e ka një rëndësi të veçantë, sepse nis një proces, i cili ka të bëjë me identifikimin e problematikës dhe zgjidhjen e saj përmes një skanimit të mirëfillt teknik", u shpreh Balluku.

Ndërsa drejtori i Institutit të Ndërtimit, Agron Hysenlliu e vuri theksin tek nevoja e një kontrolli periodik të urave. "Mendoj që duhet të bëhet një kontroll periodik, siç është kontrolli i makinave. Duhet të jenë firma të specializuara që të marrin përsipër këtë proces dhe të na japin një raport të hollësishëm për të gjitha urat", deklaroi Hysenlliu. Në raportin e prezantuar në tryezën teknike është evidentuar fakti se aktualisht në rrjetin e rrugëve kombëtare, administruara nga ARRSH ka 652 ura, si dhe 20 ura të tjera që po përfundojnë dhe ka nisur procesin e marrjes në dorëzim. Nga inspektimi i kryer në terren ka rezultuar se 30 ura janë me probleme të rënda, prej të cilave 21 ura në veri të vendit dhe 9 ura në Shqipërinë e mesme dhe në jug. Sipas ekspertëve zona veriore pa pasur më shumë probleme për shkak të kushteve atmosferike dhe sepse është zona, e cila ka përballuar një ngarkesë shumë të lartë të transportit të mjeteve të rënda ndër vite.



Situata në Zelandën e Re pas sulmit terrorist

Kryeministrja e Zelandës së Re, Jacinta Arden: Dita më e errët e vendit

Ditë zie në Zelandë, 49 viktima nga sulmi terrorist në dy xhami

Autori, fans i Radovan Karaxhiç dhe kriminelëve serbë

Masakra në Zelandën e Re, në dy prej xhamive kryesore, solli vdekjen e 49 besimtarëve. Ngjarja ndodhi rreth orës 03:00 me orën lokale ndërsa policia lajmëroi qytetarët të mos dalin nga shtëpitë. Autori një 28-vjeçar besohet të jetë admirues i nacionalistëve të Ballkanit. Dyshimet kanë ardhur pas këqyrjes së armëve të përdorura nga ai për vrasjen e njerëzve dhe momentit të filmuar nga ai vetë 'live' gjatë masakrës. Brenton Tarrant australian bashkë me disa të tjerë janë arrestuar nga policia. Kryeministrja e Zelandës së Re, Jacinta Arden, i cili e quajti ditën e masakrës, një nga më të errëtat e vendit. "Një akt i pashembullt dhune. Është një ndër ditët më të errëta të Zelandës së Re. Një ngjarje e tmerrshme". ka thënë ajo. Sipas Associate Press myslimanët përfaqësojnë 1,1% të popullsisë në Zelandës e Re.

TERRORISTI

Personi që vrau 49 njerëz në një masakër të padëgjuar prej kohësh, në dy xhami në komunitetin e Christchurch në Zelandën e Re besohet të jetë admirues i nacionalistëve të Ballkanit. Në videon e xhiruar nga vetë ai shihej në makinë teksa dëgjonte një këngë nacionaliste serbe që nderonte kriminelin e luftës, autorin e masakrave në Bosnjë Radovan Karaxhiç. Për koïncidence vendimi final për Karaxhiç të akuzuar për gjenocid dhe krime lufte pritet të jepet për pak ditë. "Karaxhiç do drejtojë serbët, Karaxhiç drejton serbët", dëgjohej në sfond, teksa pas disa sekondash ndodhi masakra me 49 të vrarë. Në Facebook ai figuronte me emrin Brenton Tarrant ndërsa kishte publikuar në adresën e tij simbole të ndryshme nacionaliste të Ballkanit dhe një deklaratë që kritikon përfshirjen e SHBA në luftën në Kosovë. Përpara vrasjeve, autori i ngjarjes së rëndë ka publikuar një "manifest" prej 73 faqesh, ku thekson se motivi i sulmit ishte "të krijonte frikë" duke përfshirë fjalime anti-emigrantëve si dhe duke bërë thirrje për vrasje të myslimanëve. Teksti, gjithashtu, përmbante një seksion rreth konfliktit në Kosovë. "Ballkanizmi, gjithashtu, do të zvogëlojë aftësinë e SHBA-së për të projektuar fuqinë globale dhe në këtë mënyrë të sig-



Autori i sulmit, Brenton Tarrant

urojë që kurrë më të ndodhë një situatë e tillë si përfshirja e SHBA në Kosovë (ku forcat e SHBA/ NATO-s luftuan përkrah myslimanëve kundër evropianëve të krishterë", thekson ai. Në armët që autori ka përdorur gjenden të gdhendura emra si ai kreut ushtarak malazez Marko Miljanov Popović, i cili udhëhoqi fisin e tij në luftën kundër Perandorisë Osmane. Një tjetër emër i shënuar në armë ishte ai i Novak Vujoseviç, i cili luftoi në anën e Malit të Zi në betejën kundër forcave të Perandorisë Osmane. Armët u shënuan, gjithashtu, me emrin Bajo Pivljanin, një komandant, i cili gjithashtu luftoi kundër Perandorisë Osmane në Bosnjë dhe Mal të Zi dhe emrin e Stefan Lazar, Milos Obiliç, Serbia ime'. Stefan Lazar, ishte Princi serb Lazar Hrebeljanovic (1329 - 1389), që vdiq në luftë me turqit në Fushë Kosovë. Ai përdori emrin mbretëror Stefan Lazar.

ARRESTIMET

Deri tani policia e Zelandës

së Re ka arrestuar katër vetë në lidhje me sulmet terroriste. Njëri prej tyre u arrestua, sepse kishte veshur një jelek vetëvrasës, ndërsa një tjetër me uniformë ushtarake u arrestua jashtë shkollës së mesme Papanui. Kryeministrja e Zelandës së Re, Jacinta Arden, e quajti të shtënat "Dita më e errët e Zelandës së Re" dhe tha në një deklaratë të premtën në mëngjes se "shumë njerëz të prekur nga ky akt i dhunës ekstreme do të jenë nga komuniteti ynë i refugjatëve dhe emigrantëve". Bilanci i viktimave në qytetin e Christchurch pas të shtënave me armë në dy xhami ka shkuar në 49 të vdekur dhe dhjetëra të plagosur. Policia ka shpërndarë edhe pajisjet shpërthyes që gjenden në automjetet të parkuara. Për masakrën e Zelandës së Re reagoi dhe kryeministri australian. "Një ekstremist i krahu të djathtë, një terrorist i dhunshëm", tha kryeministri australian, Scott Morrison, për autorin e masakrës në xhamitë e Christchurch.

Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

TENDER OPPORTUNITY FOR TAXI SERVICE BUSINESS at TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport (TIA) would like to inform the interested parties about the following tender opportunity at the Terminal Building, Departure Area. The airport is a transportation hub for Albania and it represents a unique and highly attractive location for all retailers and caterers with a double digit growth in passengers.

Prospective tenants are expected to meet the following requirements:

- Experience of provision and installation of taxi services (not necessarily service for airport). Please note at least 1 year of experience is necessary.
- Taxi license of the company related to the subject of the concession (any company which fails to meet the above criteria will not be taken into consideration).
- To participate in this process interested parties will need to retrieve the Request for Proposal which can be retrieved at Tirana International Airport, Administration Building, Rinas, only on 19 March 2019 up to 15:00 Eastern Time.

Only to the companies that will submit a formal request for participation will be given the respective set of tender documents that contain the full information for submission of the proposals.

The set of tender documents will be delivered free of charge, in a CD, upon receipt of the above forms.

All inquiries and the Expression of Interest shall be addressed by hand or **to all** the following email address:

Tirana International Airport Nënë Tereza SH.P.K		
Administration Building		
Commercial & Property Department		
Rinas, Albania		
Emails:		
Commercial Department	Alisa Gjinari	agjinari@tirana-airport.com
Legal Department	Ilir Alimema	ialimema@tirana-airport.com
Procurement Department	Albi Palushi	apalushi@tirana-airport.com

Tirana International Airport SHPK
Tirana International Airport Nënë Tereza, Administration Building, Rinas, Tirana, Albania
Phone: 00355 4 2381 600 Fax: 00355 4 2381 545
E-mail: info@tirana-airport.com Website: www.tirana-airport.com

Ja sa do të vlerësohet nota mesatare aritmetike e provimeve të Maturës Shtetërore

Voltiza Duro

Brenda pak muajsh do të zhvillohen provimet e Maturës Shtetërore për mijëra maturantë në mbarë vendin, çka do të hapë rrugëtimin akademik për ata që plotësojnë kriteret e përcaktuara nga vetë universitetet. Për të gjithë ata që dëshirojnë të vazhdojnë studimet e larta në një prej programeve të studimit në Universitetin e Tiranës, 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot kriteret për t'u shpallur fitues. Maturantët mund të njihen me mesataren e pranimit në 6 fakultetet e UT-së, përkatësisht: Fakultetin e Drejtësisë, Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Fakultetin e Shkencave Sociale, Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, Fakultetin e Ekonomisë dhe Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Gjithashtu, të rinjtë mund të marrin një informacion të detajuar mbi programet e studimit për secilin fakultet.

Zbardhen kriteret e pranimit në Universitetin e Tiranës për 2019-2020-ën

Kushtet që duhet të plotësojnë maturantët për 6 fakultete

DATAT E TESTIMIT

Nga data 7 deri në 24 qershor të këtij viti, do të zhvillohen provimet e Maturës Shtetërore 2019. Përkatësisht maturantët në 7 qershor do të nënshtrohen provimit të parë, atij të gjuhës së huaj; në 12 qershor do të testojnë njohuritë në lëndën Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, ndërsa provimi i Matematikës do të zhvillohet në 17 qershor të 2019-ës. Ndërkohë në udhëzim bëhet me dije për të gjithë maturantët e vitit mësimor 2018-

2019 se provimi me zgjedhje do të mbahet në 24 qershor.

TESTIMI

"Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2019, bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2019, miratuar me urdhrin nr. 780, datë 23.11.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në MASR dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore, të përcaktojnë testin për secilin

provim të Maturës Shtetërore. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2019 fillojnë në orën 10:00. Dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta. Testet e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga QSHA-ja", theksohet në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë. Testi për secilin nga provimet e detyruara dhe me zgjedhje do të vlerësohet me 60 pikë maksimale. Maturantët/kandi-

datët që rezultojnë mbetës në provimet e Maturës Shtetërore 2019, do të rrijapin provimet në sesionin e dytë. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, do të marrin nga shkollat listat e maturantëve mbetës të vitit shkollor 2018-2019, dhe brenda datës 5 qershor 2019, do të pasqyrojnë ato në sistemin elektronik Matura online. "Listat e maturantëve mbetës të dërgohen në QSHA, në format të printuar

dhe elektronik. Drejtoritë e shkollave njoftojnë maturantët mbetës, që të mos paraqiten në provimet e Maturës Shtetërore 2019, pa likuiduar më parë provimet e klasës. Organizimi i konsultimeve me maturantët të kryhet sipas procedurave të përcaktuara në Urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 121, datë 25.2.2011, "Për organizimin e konsultimeve në ndihmë të nxënësve maturantë"-, thuhet në Fletoren Zyrtare.

FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Programi i studimit Biologji

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), përbën 70% të vlerësimit
- b. Nota e Biologjisë 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 20%
- c. Nota e Kimisë 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 10%

2.2 Programi i studimit Bioteknologji

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), përbën 70% të vlerësimit
- b. Nota e Biologjisë 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 20%
- c. Nota e Kimisë 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 10%

Programet e studimit Kimi, Kimi Industriale dhe Mjedisore, Kimi dhe Teknologji Ushqimore

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), përbën 50% të vlerësimit
- b. Nota mesatare e Kimisë (kurrikul bërthamë viti I+II) 10%
- c. Nota mesatare e Biologjisë (kurrikul bërthamë viti I+II) 10%
- d. Nota mesatare e Fizikës (kurrikul bërthamë viti I+II) 10%
- e. Nota e Kimisë 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 10%
- f. Nota e Fizikës 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 10%

Programi i studimit Matematikë

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), përbën 50% të vlerësimit
- b. Nota mesatare e Matematikës (kurrikul bërthamë viti I+II+III) 30%
- c. Nota e Matematikës 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 20%

Programi i studimit Fizikë

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), përbën 50% të vlerësimit
- b. Nota mesatare e Fizikës (kurrikul bërthamë viti I+II) 10%
- c. Nota mesatare e Matematikës (kurrikul bërthamë viti I+II) 10%
- d. Nota mesatare e Kimisë (kurrikul bërthamë viti I+II) 10%
- e. Nota e Fizikës 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 10%
- f. Nota e Matematikës 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 10%

Programi i studimit Informatikë

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), përbën 50% të vlerësimit
- b. Nota mesatare e Matematikës (kurrikul bërthamë viti I+II+III) 15 % c. Nota mesatare e Fizikës (kurrikul bërthamë viti I+II) 5%
- d. Nota mesatare e TIK (kurrikul bërthamë viti I+II) 10%
- e. Nota e Matematikës 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 20%

Programi i studimit Inxhinieri Matematike dhe Informatike

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), përbën 50% të vlerësimit

- b. Nota mesatare e Matematikës (kurrikul bërthamë viti I+II+III) 30% c. Nota e provimit të Matematikës në Maturë Shtetërore 10%
- d. Nota e Matematikës 12 (kurrikul me zgjedhje viti III) 10%

Programi i studimit Teknologji Informaticioni dhe Komunikimi

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), përbën 50% të vlerësimit
- b. Nota mesatare e Matematikës (kurrikul bërthamë viti I+II+III) 15% c. Nota mesatare e Fizikës (kurrikul bërthamë viti I+II) 5%
- d. Nota mesatare e TIK (kurrikula bërthamë viti I+II) 10%
- e. Nota e Matematikës 12 (kurrikul me zgjedhje viti III) 20%

Programet e ciklit të parë të studimeve Bachelor në:

- Teknologji Informaticioni dhe Komunikimi
- Bioteknologji
- Fizikë
- Biologji
- Kimi
- Kimi Industriale e Mjedisore
- Kimi dhe Teknologji Ushqimore
- Informatikë
- Matematikë
- Inxhinieri Matematike dhe Informatikë

Cikli i dytë Master profesional

- Bioteknologji Mjedisore
- Informatikë Biznesi
- Inxhinieri Matematike dhe Informatike
- Teknologji Informaticioni

Cikli i dytë Master i shkencave

- Biologji Mjedisore
- Biologji Molekulare
- Fizikë
- Bioteknologji Molekulare dhe Industriale
- Kimi Industriale dhe Mjedisore
- Inxhinieria Proceseve Kimike
- Shkencat dhe Teknologjitë ushqimore
- Kimi me profilin Analiza kimike dhe vetite e lëndës
- Inxhinieri Matematike dhe Informatike
- Informatikë Matematikë
- Mësues në Kimi për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Mësues në Biologji për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Mësues në Fizikë për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Mësues në Matematikë për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Teknologji Informaticioni
- Mësues në Informatikë për Arsimin e Mesëm të Lartë

FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**Programe të ciklit të parë të studimeve Bachelor në**

- ◆ Gjuhë Angleze me profile: gjuhë angleze, përkthim dhe interpretim, studime britanike dhe amerikane
- ◆ Gjuhë Frënge me profile: gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim
- ◆ Gjuhë Gjermane me profile: gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim gjermanishtfolës, përkthim dhe interpretim
- ◆ Gjuhë Italiane me profile: gjuhë dhe komunikim, gjuhë, letërsi dhe qytetërim italiane, përkthim dhe interpretim
- ◆ Gjuhë Turke me profile: gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk, përkthim dhe interpretim
- ◆ Gjuhë Ruse me profile: gjuhë, letërsi dhe qytetërim rus, përkthim dhe interpretim
- ◆ Gjuhë Spanjolle me profile: gjuhë, letërsi dhe qytetërim hispanik
- ◆ Gjuhë Greke me profile: gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek, përkthim dhe interpretim.

Kriteret e pranimit:

-Nota mesatare aritmetike (e thjeshtë) e tre viteve të shkollës së mesme, përfshirë dhe notat e Maturës Shtetërore përbën 100%, për programet e studimit:

- Gjuhë frënge
- Gjuhë italiane
- Gjuhë gjermane
- Gjuhë spanjolle
- Gjuhë turke
- Gjuhë greke
- Gjuhë ruse

-Për programin e studimit Gjuhë angleze:

- Zotërimi i gjuhës angleze në nivelin B2, në përputhje me kurrikulën bërthamë, gjuhë e huaj e parë, Shkalla VI, Klasa XII, bazuar në vlerësimet përkatëse me notë në vitin XII
- Nota mesatare aritmetike (e thjeshtë) e tre viteve të shkollës së mesme, përfshirë dhe notat e Maturës Shtetërore 60%,
- Konkursi i pranimit për testimin e njohurive gjuhësore 40%

FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE**Programe të ciklit të parë të studimeve Bachelor në:**

- Punë Sociale
- Psikologji
- Shkenca Politike
- Administrim dhe Politikë Sociale
- Filozofi
- Sociologji

Kriteret e pranimit:**Koeficienti i shkollës së mesme**

- Shkollat e kategorive gjimnaz, gjimnaz dygjuhësh shqip-italisht, shqip-gjermanisht dhe shqip-frëngjisht kanë koeficientin 1.4
- Shkollat e kategorive pedagogjike, gjimnaz gjuhësor, shërbimet sociale dhe shëndetësore, si dhe shkolla administrim biznes kanë koeficientin
- Gjithë shkollat e tjera të kategorive profesionale kanë koeficient 1 -Nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme 40%
- Nota mesatare aritmetike e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje të MSH 30%
- Për maturantët që japin provim me zgjedhje lëndët Qytetari, Psikologji ose Filozofi-Sociologji aplikohet koeficienti
- Për maturantët që nuk japin një nga këto lëndë në provimet me zgjedhje aplikohet koeficienti 1.3.
- Nota mesatare aritmetike e gruplëndëve formuese në shkencat sociale përbën 30%
 - a. Qytetari dhe Filozofi (kurrikul bërthamë klasa 10 e 11)
 - b. Psikologji dhe Sociologji (kurrikul me zgjedhje, klasa 12)
 - për maturantët që kanë zgjedhur në klasën e 12 si lëndë me zgjedhje Psikologji ose Sociologji, ose të dyja, aplikohet koeficienti 1.2
 - maturantëve që nuk kanë zgjedhur në klasën e 12 si lëndë me zgjedhje Psikologji ose Sociologji, ju llogaritet thjesht mesatarja e lëndëve të zhvilluara nga fusha e shkencave sociale (kurrikul bërthamë, Qytetari dhe Filozofi, klasa 10 e 11)

FAKULTETI I DREJTËSISË**Studime të integruara në fushën e drejtësisë**

- Cikli i dytë Master i shkencave
- Drejtësi, me profil "E Drejtë Civile"
- Drejtësi, me profil "E Drejtë Penale"
- Drejtësi, me profil "E Drejtë Publike"

Cikli i dytë Master profesional

- E Drejtë Civile
- E Drejtë Penale
- E Drejtë Publike
- EU Business Law

Kriteret e pranimit:

- Nota mesatare e përgjithshme e të gjithë viteve të shkollës së mesme 40%
 - Nota mesatare e të gjithë provimeve të maturës shtetërore 20% Lëndët formuese:
 - a. Gjuhë Shqipe (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e provimit MSH) 10%
 - b. Gjuhë e huaj, e parë (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e provimit MSH) 10%
 - c. Letërsi (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e provimit MSH) 5%
 - d. Qytetari (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e MSH nëse e ka dhënë) 5%
 - e. Histori (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e MSH nëse e ka dhënë) 5%
 - f. Ekonomi (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e MSH nëse e ka dhënë) 5%
- Koeficienti i shkollës së mesme**
- Të gjitha shkollat e mesme gjimnaze (përfshirë gjimnazin me kohë të shkurtuar) e kanë koeficientin 1.2
 - Të gjitha shkollat e mesme me karakter profesional e kanë koeficientin 1.0

FAKULTETI I EKONOMIK**Programe të ciklit të parë të studimeve Bachelor në:**

- ◆ Financë
- ◆ Ekonomiks
- ◆ Informatikë Ekonomike
- ◆ Administrim Biznesi

Kriteret e pranimit:

- Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë) përbën 50 % të vlerësimit
- Nota mesatare e gruplëndëve (për të gjithë vitet gjatë të cilave shtrihen lëndët, përfshirë notat e maturës shtetërore) përbën 50 % të vlerësimit:
 - a. Matematikë 15%
 - b. Ekonomi 15%
 - c. Fizikë 10%
 - d. Gjuhë e huaj 10%

FAKULTETI I HISTORI-FILOLOGJISË**Programe të ciklit të parë të studimeve Bachelor në**

- ◆ Histori
- ◆ Gjuhë Letërsi
- ◆ Gjeografi

Cikli i dytë Master i shkencave**Gazetari me profile:**

- ◆ Gazetari sociale kulturore, Gazetari politike, Gazetari ekonomike
- ◆ Arkeologji

Kriteret e pranimit:

- ◆ Nota mesatare aritmetike (e thjeshtë) e tre viteve të shkollës mesme vlerësohet 80%
- ◆ Nota mesatare aritmetike (e thjeshtë) e provimeve të Maturës Shtetërore vlerësohet 20%

Publikohet në Fletoren Zyrtare lista me personat që u është njohur e drejta për kompensim

Agjencia e Trajtimit të Pronave Publikon listën e 611 pronarëve të njohur për kompensimin e pronës në vitet 1993-2013, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe është kryer vlerësimi financiar. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në të gjithë vendin si dhe vlerën financiare për secilën dosje. Lista është botuar në Fletoren Zyrtare dhe bëhet fjalë për dosje të cilave Agjencia e Trajtimit të Pronave ka dhënë një vendim. Ndërkohë në 23 shkurt ATP ndërpreu procesin e vlerësimit të dosjeve dhe pronarët që nuk janë njohur me vendimin duhet t'i drejtohen gjykatës.

KOMPENSIMI FINANCIAR DHE FIZIK

Sipas formularëve-tip, mësohet se kërkuesi duhet të

Dosjet 1993-2013, lista me 611 pronarët që marrin paratë

Përfituesit në të gjithë vendin, ja si do të paguhen

cilësorë faktin se kërkon kompensim financiar. Për plotësimin e dosjes duhet të paraqitet kërkesa për kompensim financiar/fizik, konfirmim nga ZVRPP-ja për gjendjen juridike të pronës, vërtetim nga gjykata nëse vendimi përfundimtar i vlerësimit të tij është ankuar apo jo në rrugë gjyqësore, dëshmi trashëgimie nëse ka ndry-

shuar rrethi i trashëgimtarëve, prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët, vërtetim numër llogarie, vërtetim nëse subjekti ka përfituar ose jo tokë bujqësore, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Të njëjtat dokumente duhet të paraqiten edhe në rastin kur pronari kërkon kompensim fizik.

LLOGARITJA

Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur. Këshilli i Ministrave ka rregulluar me anë të një vendimi kufirin e pagesës në lekë dhe atë të

kthimit fizikisht të pronës. Kështu, të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall përfitojnë kompensim financiar nga fondi financiar i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.133/2015, dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompen-

sohet fizikisht, nga fondi i tokës. Neni 8 pika a e ligjit nr. 133/2015 për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave thotë se subjektet e shpronësuara të nënshtrohen procedurave të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim financiar.

LISTA ME 611 PRONARËT QË MARRIN PARATË

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Tiranë	EMINE SUKAJ		1237
Vlorë	Anastas Kaçi	450	1710
Vlorë	Vasil Pandazi	1930	3520
Gjirokastrë	Arshi Hasan Demaj		4400
Durrës	Aleksander Piçoni		250
Durrës	Zeqir Subashi		1503.7
Elbasan	AHMET KOSENI		595
Gjirokastrë	Zagoll Ymeri	1175	1647
Korçë	Seit Shaholli, Xhafide Shaholli	532	973
Korçë	Kadri Hoxholli		5625
Tiranë	SHABAN SPAHIU		560
Gjirokastrë	Novruz Çela		2200
Korçë	Emine Pysqyli	469	1455
Korçë	Remzi Hoxha		4407
Shkodër	Lazer Nikaj	1400	1000
Tiranë	SEIT MEHMETI		744
Gjirokastrë	Sheri Baboci	662	312
Korçë	SKENDER KACKA	3825	3091
Korçë	Lule Zyfi		2500
Korçë	Muharem Dikolli		3000
Korçë	Tomor Vehbi		361
Shkodër	Xhevat Erkoci		180
Vlorë		5000	8670
Lezhë	Kadri Ceka		892
Fier	Myqerem Kalemaj		10018
Gjirokastrë	Lemjan ZINZINUM, Silvana ZINZINUM & Diana Tereza	2596	460
Gjirokastrë	Margo Qamo	3400	400
Korçë	Nazmi Musa	448	2552
Tiranë	TRASHGIMTARET	15820	28288
Tiranë	MYZEJEN MAÇI	640	0
Elbasan	KADRI LICI		2168
Elbasan	FEJZO XHARO		520
Korçë		330	275
Vlorë	Qirjo Danga		1280
Elbasan	Sherif Qefa		1074
Gjirokastrë	Shani Luzaj		8388
Durrës	Hasan Guza		40
Korçë	Metush Hoxha	194	586
Dibër	Petrit Pali	5423	0
Berat	HAZIS HYSKO		0
Berat	Syrja Bajraktari	4630	22370

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Korçë	Herjat, Aishe Perona	3820	1250
Korçë	Dhimiter Samara		380
Shkodër	Mati Mark Peniku		0
Shkodër	Gjelosh Bala		2261
Tiranë	ZIJA KOKOCANI		201
Vlorë	Ervehe Shamenti	564	6236
Vlorë	Lumturi Dizdari	564	9516
Vlorë	Enerjeta Thano		400
Vlorë	Petrit Bektashi		4814
Durrës		8350	2190
Korçë	Robert Floriri		120
Korçë	Lushe Sako		30
Tiranë	REXHEP QEROSI	3270	911
Vlorë	Qani Lesko	508	62
Dibër	SELVIE TAHIR SELIMAJ		1173
Korçë	XHIMA IMAKU		486
Fier	Nikollaq Bozo		8000
Korçë	Margarita Terezi	198	223
Tiranë	EMIJET VEIZI	133	983
Vlorë	Spiro Paguni	1940	1390
Vlorë	Dhionis Deneko	2290	2670
Elbasan	REFIK KAJANAKU	340	1880
Fier	Fernik Hoxha		9550
Fier	ALI GAZEPI		4670
Fier		1200	4950
Fier	Nikolla Qorri		5000
Fier	Rrapush Hallili		6250
Fier	Idajet Patozi		11000
Fier	Rrapi Prendi		2640
Fier	Xhevahir Cani	2182	4700
Fier	Gani Hoxha		15600
Fier	Qemal Çoku		11360
Fier	Yluma Ndini		30000
Fier	KRONI PRIFTI		13900
Fier	Rustem Ferra		11770
Fier	Avdurraman Sina		4400
Fier	Miter Pina		3000
Fier	Hurma Sula		3000
Fier	Memin Sula		10935
Fier	Koci Ndini		10200
Fier	Hasan Shehu	1440	9599

Korçë	Hysen Mustafa		144
Fier	Ramazan Kaja		8000
Fier	Luljeta Alla		4998
Fier	Profi Sako		8400
Fier	Brahim Cani		2800
Fier	Hurma Bufasi		4000
Korçë	Teki Feto		1281
Fier	Vangjel Cuko		11000
Vlorë	Resmi Ferraj		1460
Elbasan	ARIF SHASHAI	1924	7536
Gjirokastër	Shaqo Resuli		2638
Gjirokastër	Jani Thomollari	1396	4824
Gjirokastër	Feruze Menaj (Deliaj)		1660
Korçë	Hajdin Rusi		580
Korçë	Gezim Bala	123	0
Korçë	Kamber Musaka	600	942
Korçë	Dhimitraq Veriga		20.77
Korçë	Petraç Kondakçi		73.92
Korçë	Petraç Dishnica		16.8
Gjirokastër	Myrteza Sadikaj		1311
Tiranë	HAXHI GUZI	1100	1004
Tiranë	ARBEN MALOKU	19310	80000
Tiranë	ARIF XHAFA		4694
Tiranë	HARILLA NISHKU		1330
Korçë	Berti Nasi Dini	174	7807
Gjirokastër	Stavro Thomollari	240	3643
Tiranë	Hasan Babrama		1775
Tiranë	QERIM SHALA	653	1347
Durrës	Xhemal Veseli		11528
Korçë	Iqmet Hysi		2700
Korçë	Safet Seit	200	300
Korçë	Kosta Peti , Xhimi Peti	302	68
Korçë	Anesti Furxhi		160
Korçë	Qamil Hysi		2080
Tiranë	Arton Shashan, Derm Selencia, Migjela Tafiku, Nermir Sulcebo	8708	18176
Tiranë	SULEJMAN IBRAHIM LUGA		0
Durrës	Meriban Kasa	6045	1470
Korçë	Agron Mixha		846
Lezhë	Mark Topallaj	18302	1200
Vlorë	Vanko IEZO	1250	8470
Korçë	Bajame Biba		495
Korçë	Skënder Çekiçi	475	711
Gjirokastër	Niko Lilo	2664	1150
Gjirokastër	Thanas Papa		620
Gjirokastër	Vullnet Baduni		3920
Gjirokastër	Faik Shehu	1316	800
Gjirokastër	Bardhosh Ruci	7950	2550
Korçë	Koço Shkodrani	2487	2513
Korçë	Nurihan Jazxhi	4615	360
Korçë	Seladin Mehmet Jazexhiu	2550	3566
Korçë	Nurihan Jazxhi	4615	360
Gjirokastër	Dhimiter Koco Cuci		1292
Gjirokastër	Telo Kalluci	10069	500
Gjirokastër	Kol Puraveli	1540	60
Korçë	Remzi Fari	2740	965
Korçë	Alie Koçiu		697
Korçë	Ramadan Karafili		5111
Korçë	Hekuran Memishi	557	9433
Korçë	Shaban Tako		480
Gjirokastër	Demir Lulo	11800	3600
Gjirokastër	Dhimiter Papatotiri		528
Korçë	Hamide Lirioni, Ymer Lirioni		500
Korçë	Vanthe Cuci		315
Korçë	Mersin Kaso		401.7
Vlorë	Vasil Kosta		1500
Vlorë	Kujtim Bazaj	2180	6070
Korçë	Bashkime Moka		720
Korçë	SKENDER DENOLLI	814	1356
Berat	SELIM ÇELA		9000
Elbasan	SELIM XHANGOLLI		500
Elbasan	Reshit Bici		1616
Elbasan			9765
Gjirokastër	Ismail Cunaj	50	150
Korçë	Haki Muka		912
Tiranë	VASIL DHIMITRI		16.8
Korçë	Zarif Zyfi	2620	1987
Durrës	Sefer Kasa		5000
Elbasan	Hasan Kokonozi	853	2009
Fier	Neshat Ahmetaj		0
Fier	Nesmi Ahmetaj	1380	2070
Fier	Skender Canaku		3000
Fier	Keshilli Kishtare	1562	465
Fier	Jaho Turku	2000	1000
Fier	Njazi Lici	1346	0
Fier	Qemal Shehu		3000
Fier	Riza Shehu	349	1589
Fier	Sulejman Bejte		2038
Fier	Anastas Prifti		13675
Fier	Teki Dervishi		2000
Fier	Petrit Cela	308	2420
Korçë	Niko Nuke		13315.25
Korçë	Sami Cuko	437	1906
Korçë	Hekuran Jajolli	425	300
Korçë	Abedin Mullaj	210	845
Korçë	Demirali Meka, Muhamet Meka	531	600
Shkodër	Ahmet Musa Nehani	5000	1050
Shkodër	Kisha Ortodokse	6350	50
Vlorë	Jani Konomi	8500	500
Vlorë	Jaup Brati		190
Durrës	Rexhep Keçi	5400	400
Gjirokastër	Kosta Guzhuni	1650	600
Gjirokastër	Harikla Andoni		560
Gjirokastër	Vasil Rudi	400	600
Gjirokastër	Leonard Mero	13200	18800
Korçë	NAFI MULLA	381	2051
Korçë	Kristo Shkurti	280	446
Korçë	Nderim Tare	1620	380
Korçë	Njazi Bylykbashi		2406
Korçë	Zeliha Berberi		683
Korçë	Osman Zylfo Bilelli	1470	1231
Korçë	Mihallaq Naco	844	1690
Korçë	Piro Guçi	1285.6	2052
Tiranë	HAJDAR PLANEA	4720	0
Vlorë	Krisulla Zhupa		320
Vlorë	Kristo Cavo	1176	600
Vlorë	Haxhibarjan Pasholli	400	60
Vlorë	Dhimitër Nini		0
Vlorë	Thanas Mercuri		80
Korçë	Zarife Xhiani	466	300
Korçë	File Simeoni	852	230
Lezhë	Meme Lishi		120
Durrës	Qazim Kau	1615	300
Korçë	Qamil Hanelli	24	580
Korçë	Ali Tefik		801
Korçë	Zenel Topçiu		620
Korçë	Razi Meço		100
Korçë	Viktor Lamçe		11560
Korçë	Feti Lamçe		4120
Korçë	Filloreta Gishta		4100
Korçë	Kostandina Dvorani (Kulmi)		2100
Korçë	Avdulla Shkurti		425
Korçë	Zenel Orhani		278
Korçë	Meleq Fazlli		180
Korçë	Trajan Veriga		20.77
Korçë	Andrea Turtulli		245
Tiranë	Zenepe Hakiraj		8412

(vijon)

LETËR PUBLIKE

Nuk u takoj artistëve që brumin artistik e ngjeshin nga vuajtja, por përkundrazi, shkruaj vetëm kur çdo gjë në mua e kaplon një qetësi e mirësi dhe kur nuk ka dallgëzime të mëdha të detit jetësor

Kim Mehmeti:

Edhe një letër mikeshës! Mos bëj beteja me perandoritë e vdekura...



Ca radhë drejtuar Alda Bardhylit: Vlerat e mirëfillta janë si shkëmbinjtë...

Nga Kim Mehmeti

Edashur, i mora pyetjet që m'i kishe dërguar dhe shprej se së shpejti do t'i kthej përgjigjet. Duhet ta pranoj se tani më nuk e kam as vullnetin e as naivitetin e dikurshëm rinor, kur vetvetja më duket si krua i pashtershem i mençurisë, që i freskon të gjithë ata që i lexojnë themien e mia publike. Pra, tani i jetoj vitet kur e di se as medieve, as gazetareve, nuk u jam dashur, e nuk u duhem, pse jam gjithaq i mençur, por pse kanë besuar se nuk duhet lëshuar duarsh një llafazan si unë, i cili naivisht beson se singjeriteti është shtylla që mban në këmbë giminë njerëzore. Pastaj, të jem edhe më i qartë: gjitha bisedat e mia të deritanishme publike, nuk shpalojnë asgjë më shumë se vetëgjënjimit tim se jam duke thënë diçka që nuk është thënë deri më tani, siç tregojnë edhe atë që nuk e dija dikur, por që e di sot; shpeshherë gazetaret nuk bisedojnë me ty nga malli, por nga halli se nuk kanë me çka t'i mbushin faqet e gazetave! Por megjithatë, edhe pse tani i di të gjitha që i thash më lartë, pra edhe pse e di se lumi i urtësisë qëmoti e ka vërshuar botën, nuk ndjem keq pse i kam thënë publikisht të vërtetat e mia, sepse qysh në rimë e kuptova se shtyllat bartëse të kësaj bote janë të vërtetat që përsëriten, e deri të cilat çdonjëri arin udhë së vet, duke mos e zaptuar kopshtin e mençurisë së huaj. Dhe 'freskinë' e tyre nuk e ngërthen në vetvete ajo që thuhet, por mënyra si ajo shpalohe! E kur jemi të përsëritjet e të vërtetave që dihen, nuk duhet harruar se lindja e vdekja janë përsëritur aq herë, saç kanë lindur, e sa ç'ka ecur vdekatar mbi këto tokë, por megjithatë lindjevdekjet janë të freskëta si të kishin ndodhur vetëm njëherë të vetme dhe ato çdonjëri i përjeton si diçka që kur më nuk ripërjetohet. Siç e përjeton çdonjëri në mënyrë të vet edhe kalbjen e qelbjen e sotme të vlerave njerëzore në ne, që aq shumë kundërmojmë

më erë të keqe, sa nuk mund ta mbulojmë as me 'parfumet' e shtrenjta që i përdorim! Dhe ngaqë e fillova këtë letër thujse mbrapsht, të shtoj edhe më të dhembshmen që ka të

bëjë me kotësinë e përsëritjes së të vërtetave, e që e kanë thënë shumë dijetarë: se këshillat dhe thëniet e urta, thujse aspak nuk kanë ndikim, ngaqë të mençurit

nuk kanë nevojë për to, politikanët e pushtetarët nuk u besojnë dhe budallenjtë nuk i kuptojnë! Dhe andaj njeriu që publikisht i shpalojë të vërtetat dhe mendimet e veta, nuk duhet të lodhet me atë që e thonë për të injorantët, sepse më shumë të lartësojnë e të nderojnë sharjet e të pafytyrëve dhe budallenjve, se sa lëvdatat e të ndershmëve dhe të mençurve!

Pastaj, pyetjet tua më arrijnë në kohë kur jetoj me bind-

jen se nevojë për të velur sa më shumë dituri, vjen nga pamundësia që t'i pushtojmë thellësitë e paskajshme të urtësisë dhe të vërtetave që janë thënë. Madje besoj se sikur t'i dinim gjitha që janë shkruar dhe që janë trëfyer, sikur të mund të ishin pronarë të urtësisë gjithënjëzore, atëherë do i dorëzohehim heshtjes dhe do ndjenim si në ne vshket e shuhet të menduarit dhe imagjinata, si na mbërthen robëria e gjithënjohjes dhe gjithëdijes, e që jetën e bënë të pajetueshme. Pra, që çdo gjë rreth nesh e bënë të frikshme sa vetë lindja e vdekje, sa dy aktet që gjithë i kemi përjetuar, por duke mos mundur askush t'i rikujtojë e t'i përshkruaj ato. Sidoqoftë, pyetjeve tua ua hodha një sy dhe më erdhi mirë që mes tyre nuk ishte ajo më e bezdisshmeja, që kërkon shpjegim se çka kam dashur të them në veprat e mia. E përgjigjen e së cilës e dinë vetëm kritikët letrar dhe lexuesit, që ndonjëherë zbulojnë ta kem thënë edhe atë që mendoj se nuk e kam shkruar. Me çka përfundimisht jam bindur se veprat e mia nuk tregojnë atë që kam shkruar, por atë që lexon lexuesi. Dhe se vlerat e mirëfillta janë si shkëmbinjtë, ku mund të ngjiten shqiponja e zvarranikët, por nga ku jo çdokush sheh njësoj larg e thellë! Në mesin e shumë pyetjeve tua më bëri përshtypje ajo se si do e përshkruaja atë nxitje dhe nevojë që publikisht të thuash ato që mendon dhe gjithëve t'ua shpalojë atë që pëllë imagjinata jote. Apo thënë edhe më qartë: si lind vepra! Kësaj pyetje mund t'i përgjigjem aq sa edhe hiri pyetjes se si është ndje përderisa ka qenë dru i përshkur nga flaka e zjarrit. Pra, është thujse e pamundur të shpjegohet kjo nevojë, njësoj sikur mund të shpjegohen pasionet tona, të cilat ndoshta nuk janë asgjë tjetër përpos uri që jeta ka për vetveten. Madje kjo pyetje më ngjason sikur ta pyesësh të griposurin pse i dhemb koka, dhe nëse ai do mundet që kokëdhembjen ta shndërronte në dhembje të barkut. Dhe ndoshta jo rastësisht tani m'u kujtua kokëdhembja, ngaqë ka vite

që nevojën për të shkruar e ndje si sëmundje, por nga e cila nuk dua të shërohem, për të cilën as kërkoj as mund të gjej ilaç. Pastaj edhe jam i lumtur që është e pashërueshme dhe që nuk ka barnatore ku do mund të blije ilaç për të. Shpeshherë jam mundura ta përshkruaj këtë sëmundje, por nuk ia kam dal. Por e di se ajo vjen e shkon e paparalajmëruar dhe më kaplon vetëm kur jetojë në paqe me vetveten. Pra, nuk u takoj artistëve që brumin artistik e ngjeshin nga vuajtja, por përkundrazi, shkruaj vetëm kur çdo gjë në mua e kaplon një qetësi e mirësi dhe, kur nuk ka dallgëzime të mëdha të detit jetësor. Dhe kam përshtypjen se atë a kam nga të lexuarit librin që do doja ta lexoja.

Sidoqoftë, kjo sëmundje më kaplon rrallë herë dhe nuk më zgjat shumë. Dhe kur vuaj nga ajo, trupin e ndje si një qerre që ka bredhur nëpër shumë shtigje jetësore, e nga e cila posa ka zbritur udhëtari i vetëm në të -shpirti. Qerre të cilën e kanë braktisur kuajt e lodhur që e tërheqin - ndjesitë, e që vrapojnë nëpër livadhet e paskajshme, ku kullotin librat që kam lexuar. Mbi shpinën e tyre shihen edhe dizgjinët - imagjinata ime - e cila nuk i pengon të vrapojnë nga të duan. E në ndërkohë, shpirti prehet mbi faqet e shkruara dhe mbase kujton grupat nga ka kaluar qerrja, e cila nga dita në ditë vjetrohët dhe e humb bukurinë e viteve fëmijërore dhe rinore. E kam bredhur nëpër botë mjaftueshëm që ta kuptoj si të sillm në mjedisë si këto nëpër "Shqipëritë" tona, ku askush nuk të mbron nga ujku i gjallë dhe ku të gjithë e godasin ujkun e ngordhur, ku mund të të hajë ujku dhe askush mos të të mbrojë. Apo që ta kuptoj se nuk ia vlen ta mbros të vërtetën në mjedisë si këto tonat, ku të pambrjoturit të gjithë i bëhen gjuqtar, e të pushtetshmit rojtat! Në ato mjedisë njerëzit nuk jetojnë as në paqe me vetveten as me të tjerët, por i vazhdojmë betejat kundër perandorive të vdekura, me çka merrem me "rindërtimin" e të kaluarës së largët, e jo të së sotmes dhe të së ardhmes së tyre.



Dega Fibank Vlorë Stabilitet dhe rritje e vazhdueshme

15 Mars 2019

Dega Fibank Vlorë ka treguar në vite stabilitet në performancë dhe rritje të vazhdueshme në të gjithë indikatorët e biznesit. Nën menaxhimin e z. Robert Sejdiaj, dega Vlorë është nga më të mirat e rrjetit Fibank. Së fundmi është rinovuar tërësisht në infrastrukturën logjistike dhe është plotësuar me një ekip profesionistësh të dedikuar.

"Ndihem e privilegjuar të jem pjesë e stafit Fibank, në të cilën kam gjetur një ambient që siguron kushtet optimale të punës, transparencë, besim, mbështetje dhe meritokraci. Klienti është në qendër të gjithçkaje që ne bëjmë. Ndihem krenarë për mundësitë që ofrojmë për ta me produktet e Fibank" - shprehet punonjësjë më e re e Degës, Kristi Vallaj.

"Fibank Albania investon tek punonjësit e saj si kontribuuesi kryesor në suksesin e Bankës. Këtu gjeta mundësi të barabarta në lidhje me trajnimin, zhvillimin, promovimin dhe arrijtjen në karrierë. Ndihem shumë e respektuar që përpjekjeve të gjithë stafit i bashkoj kontributin tim në arrijtjen e një shërbimi sa me profesional të kualifikuar ndaj çdo klienti."

Skuadra Fibank si në Vlorë edhe në çdo njësi tjetër, është e dedikuar në rritjen e bazës së klientelës duke i kushtuar rëndësi të veçantë çdo tipi klienti, duke i shërbyer klientëve të mirë potenciale me cilësi dhe produkte të dizenuara me kujdes.



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 652

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela Aliaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 16 Mars 2019

"ME BLEDIN"

'NGA RESTORANTI NË DHOMËN E GJUMIT, NJË
'REALITY SHOW' PËR TË NJOHUR PERSONAZHET VIP'



EKSKLUZIVE

Flet gazetari: Edi Rama dhe Dua Lipa, ja personazhet që preferoj më shumë.
Një jek instinktet e mija, shkoj pas asaj që më thotë trupi, mendja e zemra

"KE LEKË TI"


Aurela Gace i kthen përgjigjen
epike ndjekëses në 'Instagram'



KENGET

HITET E REJA

Të gjitha në një mendje!
VIP-at po i këndojnë
dashurisë së pamundur



TË JETË E VËRTETË?

NDAHEN RONELA
DHE YOUNG ZERKA!



Nga “Tavolina e Mërzisë” e Elvanës tek “A e mban mend” e Dafit, këngët që ju prekin më tepër

Të gjitha në një mendje! VIP-at po i këndojnë dashurisë së pamundur

Rikthehen Vesa Luma dhe Tuna Sejdiu me baladat zemërthyesë

Pamela Aliaj


Tashmë është kthyer në trend t'i këndosh zemrës së thyer e ndjenjave të një dashurie të parrealizuar. Mesa duket kohët e fundit këtë trend, sikur ta 'kenë bërë me fjalë' janë duke e ndjekur këngëtarët tona të cilat i përshtaten më së miri edhe kësaj rryme. Dikush që nuk është më, dikush që nuk diti të të vlerësojë apo dikush që të theu zemrën në mijëra copa, nën tingujt e këngëve të tipit baladë të këtyre këngëtareve shumë prej nesh mund të gjejnë vetveten. Por ajo që bën akoma më tepër çudi është stili që kanë zgjedhur të ndjekin në rikthimin e tyre disa këngëtare që i mungonin skenës prej disa kohësh si Vesa Luma apo Tuna Sejdiu, të cilat sërish zgjedhën baladën për t'u rikthyer në skenë. Një zgjedhje e zgjuar që do bëjë të mbeten për një kohë të gjatë në zemrat e dëgjuesve këngët e tyre. Ndër to listojmë disa më poshtë dhe zgjidhni ku e gjeni më tepër veten

VESA LUMA

Pas një shkëputje të gjatë, Vesa Luma paralajmëroi që po përgatitej t'i rikthehej tregut muzikor. Këngëtarja publikoi dje për herë të parë një copëz nga kënga e saj më e re e titulluar "Spaska qenë e shkrume". Në këtë projekt Vesa nuk vjen vetëm, por në një bashkëpunim me këngëtarin Denik Prizreni. Nga ajo që arrijmë të dëgjojmë kup-tojmë se flitet për një baladë dashurie, ndërsa këngëtarja dalohet duke ecur drejt një pianoje të vendosur në natyrë. Ashtu si këngët e tjera baladë të saj, presim që dhe kënga e re e Vesës të kthehet në një hit duke qenë se Vesës i shkon shumë për shtat një stili i tillë i veçantë. Kujtojmë që më parë ajo ka bërë bujë me një ndër këngët e saj të parapëlqyera nga publiku, "Edhe një fundvit".

ELVANA GJATA

Pas këngës të stilit baladë, "Tavolina e mërzisë", një këngë që vazhdon të komentohet nëpër rrjetet sociale dhe është punuar nga dëshja Aida dhe Armend Rexhepagiqi, Elvana Gjata ka publikuar dje një copë nga videoja e re e këngës së saj që titullohet



"Pa dashuri". Ajo mesa duket e ka nisur shumë vullshëm vitin e ri 2019. Kënga e re "Pa dashuri" duke e parë nga teateri paraqet Elvanën si nuse ndërkohë është në bashkëpunim me reperin Lyrical Son. Elvana nuk ka publikuar ndonjë datë se kur do të publikohet kënga, por që ka thënë se ajo do të vijë së shpejti e me shumë mundësi është zemërthyesë si ajo e mëparshmeja.

DAFINA ZEQRIRI

Dafi së fundmi erdhi në një stil unik, siç di të shfaqet gjithnjë ajo dhe provokues gjithashtu. Por kënga i referohej një dashurie të shuar prej kohësh. Kënga e saj e re e titulluar "A e man n'men" në bashkëpunim me Bled Krasniqin, i cili është producent i këngës ndërsa nuk kanë munguar as provokimet në videoklip për të cilat ajo njihet e kësaj radhe erdhi tërësisht e zhveshur. Kënga tashmë është publikuar në kanal "Youtube" dhe sigurisht është pëlqyer shumë nga adhuruesit e këngëtares. Një këngë që i drejtohet dikujt që s'është më pranë saj dhe nuk ka më ndjenjë për të. Një baladë alla Daffy e cila u prit mjaft mirë nga ndjekësit e saj duke e ripostuar ditë pas dite nëpër rrjetet sociale.

ALTUNA SEJDIU (TUNA)

Pas një mungese shumë të gjatë, këngëtarja e njohur, Tuna Sejdiu u rikthye në formën e saj më të mirë me një koncert në Shkup duke mbledhur rreth vetes shumë figura të shquara. Ajo zgjodhi mënyrën e saj më të mirë duke promovuar albumin e saj më të ri me një koncert në Shkup pikërisht në Ditën e Gruas këtë 8 mars. Pas përfundimit të tij ajo vendosi t'i dhuronte audiencës albumin të firmosur prej saj. E veçanta e kopertinës së albumit është se ajo i kushton disa fjalë zemre djalit, Tianit. "Tian, haqe të gjitha portat e shpirtit tim. Të do mami", shkruan Tuna, ndërsa duket se djali ka qenë frymëzim për të. Albumi ka shtatë këngë dhe mes tyre një bashkëpunim me Armend Rexhepagiqin dhe një me Yll Limanin të cilat janë këngë të ndjera të kushtuara dashurisë.

1. Tani m'ha: zemer
2. A doni fiala feat. Yll Limanin
3. Plage
4. Këqsi mu kanë përzi
5. Harrova feat. Armend Rexhepagiqi
6. Dreqi e marrë
7. Nëse udës e re

Bukuroshja shqiptare ndryshon look, shfaqet me bikini dhe flokë të shkurtër

Ajo është padyshim një nga femrat më të bukura shqiptare. Adrola Adushi ka një bukuri natyrale dhe ëmbëlsi që e transmeton në çdo paraqitje të sajën. Por së fundmi ajo pothuajse nuk njihet fare në postimin e bërë në 'Instagram'. Adrola ka treguar linjat seksi e veshur vetëm në bikini derisa dukej në super formë si gjithmonë por me flokë të shkurtër. "Duke e pritur verën" ka shkruar Adrola. Kujtojmë se ajo prej kohësh po jeton në mes Kosovës dhe Amerikës për shkak të karrierës së saj.



Mos e humbisni! Rita Ora publikon hitin e ri me 2 këngëtares e njohura


Këngët ritmike janë gjithmonë të preferuara nga publiku duke qenë se zënë një vend goxha të konsiderueshëm në botën e muzikës. Ndërkaq edhe këngëtarja jonë, Rita Ora provoi të kalojë në një stil të tillë me publikimin e ri të hitit të pranverës. Këngëtarja shqiptare vjen në një projekt me dy këngëtares të njohura Sofia Reys dhe Anitta. Kënga mban titullin "R.I.P." dhe nëse e dëgjoni do të kuptoni se i përshtatet shprehjes: "U prehshi në paqe broçkulla". Rita nuk kishte njoftuar herë për këtë bashkëpunim, ndërsa në postimin e saj në Instagram shprehet se është shumë e lumtur që u bë pjesë e këtij projekti. "Shumë e lumtur që jam pjesë e RIP, me të mrekullueshmet Sofia Reys dhe Anitta. Faleminderit të gjithëve për përkrahjen", shkroi Rita në 'Instagram'. Ja vlen për t'u dëgjuar!

"Ke lekë ti", Aurela Gaçe i kthen përgjigjen epike ndjekëses në 'Instagram'

Aurela Gaçe është një nga këngëtares më unike me të cilën krenohemi shumë dhe më të spikatura për tipin e saj të drejtpërdrejtë. Përgjigjen nuk ia lë mangët as atyre që i lënë komente jo të hijshme në 'Instagramin' e saj. E ndërsa ndodhet për koncertet e saj në Amerikë, Aurela gjeti kohën për t'iu përgjigjur disa prej ndjekësve të saj. Ajo postoi një video në 'Instagram', ku thoshte datat dhe vendet ku mund ta ndjekin të gjithë shqiptarët që jetojnë atje. Videoja mori menjëherë mijëra pëlqime e qindra komente, ku njëri prej ndjekësve nga videoja iu duk sikur këngëtarja ishte e pirë. Komenti është parë nga Aurela, e cila i është përgjigjur: "hahaha po vetëm mes nesh kam parë edhe të ta kenë xhan, edhe të fe 'grykujnë' pakska".



Mesa shoh videon, as goja s'më merret, fjalët me diksion të plotë, mendimet e qarta... kështu që vërtetë se kuptoj si i thuhet dikujt dukesh e pirë kur ka kafe në dorë. Këtë nga flas unë tani është orar për të ngrënë, jo për të pirë. Nejshe. Të falënderoj për respektin". Ndërsa një tjetër i shkruan sesa shumë para ka arritur që të bëjë këngëtarja me koncerte, përmes shprehjes "leku letër". Pasi ka lexuar komentimin, këngëtarja me ironi i ka ofruar një vend pune. "Aman se më duhet një llogaritar, mua, atyre që bëjnë vizat, atyre që marrin me qira ambientet, veglat, biletat e avionëve, hotelet, fustanet etj. etj. Si thua? Apo ç'e do, ti ashtu ashtu i qan llogaritë e të tjerëve që për së largu", i përgjigjet ajo.



I fshiu të gjitha fotot e gruas nga 'Instagrami', këngëtar shqiptar rrëfen të vërtetën

Jo më larg se muaji dhjetor, këngëtar i njohur, Skerdi kurorëzoi dashurinë me Vesa Ramën, gazetaren e Klan Kosovës. Por vetëm pak kohë më pas u mendua se çifti i kishte dhënë fund romancës, pasi këngëtar i fshiu të gjitha fotot me të nga 'Instagrami'. Dje Skerdi vendosi të përgjigjej vetë për situatën, pasi u pyet nga një prej fansave. "A je ndarë nga gruaja, se të gjithë kështu po thonë?", i shkroi një ndjekës, ndërsa këngëtar iu përgjigj shkurt: "Jo, s'jam ndarë". Ndoshta dyshja do vetëm të shijojë romancën larg vëmendjes së publikut, ndërsa pak ditë më parë Skerdi njoftoi se do të shkëputet nga muzika për pak kohë. Profili mund të kalojë edhe biznesi dhe të qëndrojë larg vëmendjes së jetës private. Mbase këtë ka zgjedh të bëjë reperi pas martesës me gazetaren.



Vjen "Me Bledin", flet gazetari: Edi Rama dhe Dua Lipa, ja personazhet që preferoj më shumë

Rikthehet

BLEDI STRAKOSHA:

Nga restoranti në dhomën e gjumit, një 'reality show' për të njohur personazhet VIP

Pamela Aliaj

16 vite më parë, atëherë kur formatet e sotme të "showbiz"-it dhe intervistat me personazhet e njohur ishin thuhje inekzistente, spikati emisioni "Blue", e cila nisi transmetimin në vitin 2003. Ndërkohë që pati një shkëputje disaveqare, ditën e djeshme hapi siparin simotra e këtij emisioni, e drejtuar po nga i njëjti moderator, e njëkohësisht ideator i programit, Bledi Strakosha, i quajtur "Me Bledin". Projekti më i ri u përshatet modernizimit të viteve ku jetojmë dhe stili të jetës së personazheve, duke i sjellë më afër me publikun thuhje një "reality show". Në bazë ky program ka bisedën me Bledin, ku personazhe të njohur do të rrëfijnë disa sekrete të jetës së tyre. Ndërkohë për të rrëfyer më tepër rreth kësaj risie, Bledi Strakosha, në një intervistë ekskluzive për "Blue-tooth" të "Gazeta Shqiptare" rrëfen prapaskenat e "Me Bledin", një "night show" mund të themi. Për të njohur më në intimitet personazhet e për t'i parë ata edhe të çliruar nga petku i personit publik, Bledi sjell në formatin më të ri të zhvilluar në ambientet luksoze të hotel "Plaza". I gjithë emisioni është konceptuar të ndërtohet në ambiente të ndryshme: restorant, palestër, SPA, në dhomën e gjumit etj. "Në restorant do të jetë më e përgjithshme si bisedë, rreth karrierës, familjes, fëmijërisë. Në palestër do flasim për kujdesin estetik dhe shëndetin, ndërsa në dhomën e gjumit nuk do jemi domosdoshmë-

ish në shtrat. Kjo varet nga sportiviteti i tyre dhe konfidencialiteti që kemi me ta. Shtrati është më tepër simbolik sesa real. Supozohet që biseda të jetë e fokusuar te zgjedhjet personale: dashuritë e para, mendimet që kanë rreth martesës etj.", ka thënë Bledi.

Pas një shkëputjeje 16-vjeçare, i riktheheni sërish ekranit me emisionin që hapi siparin e shumë të tjerëve në vijim, "Blue", tashmë me një tjetër emër, "Me Bledin". Pse pikërisht tani ky rikthim?

"Bluja" solli një risi, sepse ishte një format ku flitej për jetën me personazhet dhe flitej pa një kohë të kufizuar televizive. Ka pasur edhe emisione që kanë zgjatur 2 orë e gjysmë. Solli vëmendjen e parë ndaj jetës së personazhit në një hapësirë televizive. I rikthehem "Blusë" me titullin, "Me Bledin", pas kaq vitesh në një format që ngjason me të në kuptimin që u dedikohet tërësisht të ftuarve, por mënyra se si zhvillohet është shumë më moderne, bashkëkohore dhe miqësore. Kur bëja "Blunë"

isha 24 vjeç dhe këta personazhe ishin idhujt e mi. Ndërsa sot jam 40 vjeç, kështu që mund të them që shumë nga personazhet që ftoheshin në programin "Me Bledin", unë tashmë i njoh prej vitesh, sepse kam bashkëpunuar prej kaq kohësh. S'do të jetë një intervistë, por një bisedë për jetën e tyre, do të ketë mendime brenda, reflektime që ka secili prej nesh. Një lloj empatie e përbashkët në këtë bisedë si dhe argëtim, në një ambient luksoz siç është "Plaza".


Çfarë do të ketë ndryshe

emisioni "Me Bledin" në krahasim me atë të disa viteve më parë?

Së pari, do të sjellë personazhe krejt të tjerë. Pra, shumë pak nga personazhet që kanë qenë të ftuar në "Blue" do të jenë të ftuar në programin "Me Bledin". Gjithë këto vite sigurisht që kanë dalë edhe personalitete të reja në fusha të ndryshme. Do sjellim një vëmendje shumë të madhe ndaj Kosovës, çka mungon në mediat tona, sidomos në këtë lloj formati, për shkak teknike apo financiare. RTSH-ja më ka mbështetur të sjellim personazhe nga Kosova në Tiranë, t'i intervistojmë në këtë format. S'kam pyetje të parapërgatitura në këtë format, pavarësisht se gjatë gjithë javës e ndaj kohën me personazhet dhe informohem rreth çdo lloj hollësie për ta. Është një bisedë e lirë për jetën, si i kanë kaluar momentet kyçe të tyre, por jashtë tensionit televiziv. Biseda kalon nga restoranti në SPA dhe më pas në dhomën e gjumit, kalon më e çtensionuar dhe jo dhe aq televizive.

Keni thënë se ndër të tjera vendi i "rrëfimit" të personazheve tuaj do të jetë një "udhëtim" nga bari paradite deri tek dhoma hotelit në darkë për të rrëfyer sekretet e tyre. Pse pikërisht kjo zgjedhje njëditore e intervistimit të të ftuarit?

Biseda nis në mbrëmje në restorantin e hotel "Plazës" e pastaj kalon në ambiente të tjera, sipas preferencës dhe stilit të jetës së të ftuarve. Personazhet që preferojnë



sportin do më bashkohen në palestër, ndërkohë që ata që kujdesen për estetikën do më bashkohen në një masazh në spa. Do të jetë një udhëtim, sepse edhe biseda i përshatet ambientit ku ne shkojmë. Në restorant do të jetë më e përgjithshme si bisedë rreth karrierës, familjes, fëmijërisë. Në palestër do flasim për kujdesin estetik dhe shëndetin, ndërsa në dhomën e gjumit nuk do jemi domosdoshmërisht në shtrat. Kjo varet nga sportiviteti i tyre dhe konfidencialiteti që kemi me ta. Shtrati është më tepër simbolik sesa real. Supozohet që biseda të jetë e fokusuar te zgjedhjet personale: dashuritë e para, mendimet që kanë rreth martesës etj.

Çfarë ju ka frymëzuar për të riardhur sërish dhe pse pikërisht në këtë lloj formati?

Prej vitësh kam gjetur kënaqësinë duke xhiruar pas kamerave me dron dhe në shumë formate të tjera. Unë e kam nisur si gazetar dhe prezantues, është një pasion që nuk vdes kurrë. Kisha shumë kohë që mendoja të rikthehesha, por doja të rikthehesha me diçka që do ta doja shumë dhe në kushtet më të favorshme të mundshme, të cilat erdhën falë RTSH-së dhe hotel "Plazës". Këto lloj formatësh kanë nevojë për pauzë dhe pas një shkëputjeje të "Blue", ishte momenti për ta rikthyer sërish brenda kontekstit të 2019-ës.

Keni pasur ndonjë propozim tjetër, apo projekt tjetër përveç këtij që do të hapni siparin këtë të premte?

Propozimet për të bashkëpunuar me televizione kanë qenë të ndryshme, por RTSH-ja mbetet dashuria ime e parë profesionale. Kur kam nisur të punoj ka qenë aty para shumë vitesh dhe ishte media e vetme në Shqipëri radio-televizive. Jam fokusuar aty duke bërë punë të ndryshme si redaktor, autor programesh në radio e televizion. Kam pasur propozime nga televizione private. Më i fundit ka qenë nga "In TV", për të realizuar një format ku një personazh ndiqet 24 orë nga kamerat dhe intervistohet gjatë ditës së tij. Mund të ishte një personazh nga më i thjeshti, deri tek më i rëndësishmi i vendit. Kemi bërë një projekt pilot, i cili edhe është publikuar edhe në 'FB' tim dhe është pritur shumë mirë. Por, erdhi propozimi nga RTSH-ja për të bërë këtë format dhe mu desh t'i përkushtohem për momentin formatit "Me Bledin", ndërkohë që formati tjetër mund të vijë në një të afërme ose në "In TV", ose në ndonjë ekran tjetër.

Me çfarë është marrë Bledi gjatë pauzës së bërë ndaj ekranit?

Kam investuar shumë në njohuritë teknologjike. Kam mësuar kamerën dhe montazhin e si përdoren ato. I kam dedikuar kohë kompanisë sime për të realizuar disa videoklipe që promovojnë Shqipërinë me dron, duke qenë se kam pa-



sur kuriozitetet e shumë audiencë, sidomos nga emigrantët dhe të huajt. Jam marrë me formatet të ndryshme televizive herë pas here, ndërkohë që tani kthehem me një format që do të zgjasë për një kohë të gjatë.

Ju zgjodhët "Plazën" apo "Plaza" ju? Pse pikërisht ambientet e një hoteli e jo në shtëpinë e personazhit për ta prekur më afër përditshmërinë e tij?

E zgjodha unë "Plazën" dhe për fat edhe pronarët zgjodhën këtë format, duke qenë se kanë propozime edhe nga të tjerë. U zgjodh ambientet e "Plazës", sepse është i vetmi ambient luksoz, i rehatshëm që i ofron të gjitha ambientet. Është si një shtëpi e personazhit. Mund të bëhej edhe në shtëpinë e personazhit publik, por duhet theksuar që jo të gjithë i kanë kushtet ideale për të realizuar një format të tillë,

disa të tjerë e kanë privatësinë shumë të shtrënjtë, kështu që do ngurronin të hapnin portat e shtëpisë së tyre. Do ishin më të lirshëm në një format që është konceptuar si dy miq që takohen në një vendtakim ideal dhe ndajnë mbrëmjen së bashku. Kështu që u menduan ambientet e hotel "Plazës", që ndër të tjera janë shumë televizive, dalin vërtetë bukur.

Cili është personazhi politik apo i "showbiz"-it që do të donit të kishit të ftuar special në emisionin tuaj?

Personazhi kryesor që unë do doja të kisha në emision dhe nuk e kam intervistuar asnjëherë është kryeministri Edi Rama. Por, për shkak të situatës politike nuk mund ta kem në program, por do të përqipem që të jenë pjesë e saj. Ndërkohë, që përta i përket "showbiz"-it, do të doja të

bëja një intervistë me Dua Lipën. S'e di nëse do të jetë e mundur, megjithatë jam në kontakt me stafin e saj, shpresoj të realizohet.

A do të ftonit politikane si Fatos Nano apo dikë tjetër "të larguar nga politika" në emisionin tuaj?

Patjetër që Fatos Nano do të ishte një i ftuar ideal, sepse ka dhënë shumë për këtë vend. Ka qenë pjesë aktive për shumë kohë plus dhe shumë i formuar. Sali Berisha gjithashtu, pra ka shumë personazhe të politikës dhe jo vetëm, që edhe pse s'janë shumë aktivë në moment, ngjallin interes për formatin "Me Bledin".

Çfarë ka të veçantë dhe ndryshe "reality show" që ju keni dashur ta quani nga emisionet e tjera të "showbiz"-it?

"Me Bledin" është vërtet një "reality show", sepse regjistrohet pa ndërprerje. Nuk ka një marrëveshje paraprake me personazhin, pra është një bisedë e çlirët dhe ndër të tjera i sheh personazhet në situata të ndryshme: si ushqehen, si bëjnë palestër, si kalojnë kohën në SPA apo në një dhomë gjumi. Ndryshe nga emisionet e tjera të "showbiz"-it, ne thellohem në jetën e personazhit, ndërkaj që "showbiz"-i është sipërfaqësor si në temat, edhe në minutazhin për personazhin.

Nëse do të mundeshit, do të ftonit personazhe të huaja në emisionin tuaj?

Nëse do të mundeshit, do të intervistoja edhe personazhe të huaja, por është e vështirë, sepse një personazh zgjedh të japë intervista për një audiencë që i intereson. Është një marrëdhënie interesante. Megjithatë mbaj mend që kam intervistuar Paolo Coelho dhe audiencia ka qenë

maksimale. Shpresoj të kemi raste, por nuk kam asgjë konkrete.

Po një ditë me Bledin si është?

Më pëlqen kjo pyetje, sepse një ditë me Bledin është ashtu siç është në program. Unë për të nxjerrë në pah një veçori apo moment të të ftuarit apo të ftuarës preferoj të rrëfej edhe një copëz edhe nga jeta ime. Pra, është vërtetë një ditë edhe me Bledin, prandaj edhe titulli është kështu. Është vërtetë një ditë edhe me mua. Në rastet kur kam mundësi të bëj një jetë kaq të qetë apo kaq luksi siç bëjmë ne në këto mbrëmje, bëj këtë gjë: shfrytëzoj ambientet më të mira dhe më të përshatshme për të shijuar një darkë të mirë për të bërë pak palestër, por më pëlqejnë edhe SPA edhe hotellet me 5 yje, pra hotelet e mira.

Duke qenë se përqendroheni në të jetuarin e një dite, do të preferonit më tepër ta kalonit vetëm e midis luksit të një shtëpie, një hoteli, apo në rehatinë e një shtëpie të thjeshtë dhe personit të zemrës?

Nuk mendoj se duhen bërë dallime mes një ambienti luksi apo një ambientit të thjeshtë. Sepse është kjo që ju përmend në pyetje: ka rëndësi që të jesh me personin e zemrës apo në rastin tim, me qenushët e mi. Ambienti ndihmon apo kufizon disa gjëra, por në thelb nuk ka rëndësi. Për t'u relaksuar apo për të kaluar një kohë sa më të mirë në vende si restoranti apo SPA, luksi ka rëndësi sepse përthekohet në cilësi të produktit që konsumon apo shërbimit që t'i merr.

Çfarë kushti do t'i vinit vajzës nëse do donte t'ju bënte për vete?

Nuk jam natyrë që vë kushte. Unë ndjek instinktet e mija. Shkoj pas asaj që më thotë trupi, mendja dhe zemra ime.

Po Bledi vetë kur ndihet komod dhe mund të shprehet lirshëm për veten: në një intervistë mbrëmjeje para një gote vere apo pranë dikujt që e njeh dhe ju interviston para prozhektorëve e kamerave të një studioje?

Nëse unë marr vendim për të dhënë një intervistë për veten time, gjë që e bëj shumë rrallë. Ndiheh komod në çfarëdo lloji rrethane, sepse edhe ambienti televiziv është një ambient ku unë jam rritur prej 27 vitesh tashmë. Por, natyrisht që përpara një gote vere dhe përpara një mikeshe apo një mikru do ndihesha shumë më i çlirët, kështu që aty do të isha më komod, në një bisedë të ngjashme në këtë që po zhvillojmë në programin "Me Bledin". Dhe prandaj e kam menduar kështu edhe për të ftuarit e mi, që t'ua lehtësoj këtë lloj komunikimi televiziv, duke i fshehur kamerat në maksimum. Pra në ambientin ku ne xhirojmë, kamerat janë pothuajse të padukshme dhe është vërtet një ambient ku jam unë me të ftuarin.



Vjen hiti i shumëpritur? Motrat Istrefi sjellin surprizën e radhës


Më parë këngëtarja tashmë me famë botërore, Era Istrefi ka thënë se ishte duke përgatitur një këngë, e cila do të ishte hiti i radhës së bashku me motrën e saj, Nora Istrefi.



Tashmë ato të dyja e kanë gati projektin. Premtimi i motrës së vogël është shumë afër për t'u realizuar. Kështu së paku kanë shkruar disa portale dje, ndërsa Nora ka disa muaj që nuk ka ardhur me ndonjë këngë të re. Për herë të fundit Nora realizoi bashkëpunimin e saj me Skerdin "M'ke mungu", një këngë ritmike kjo e cila ka më shumë se gjashtë milionë klikime në Youtube. Arsyeja pse besohet që Nora dhe Era do të sjellin këngë të re është se ato



janë parë në Prishtinë së bashku shpesh muajin e fundit, derisa Era kishte lënë Amerikën për t'u kthyer në Kosovë në mesin e disa projekteve të saj të rëndësishme atje. Kënga e fundit e Erës është ajo e publikuar para një muaji, "Like Mike" me Dimitri Vargas, një këngë që ka kaluar një milionë klikime në Youtube.



Bashkë për pushime? Tayna dhe Noizy 'kapen mat' në Tajlandë?

Pas shumë impenjimeve me koncerte të ndryshme, këngëtarët e kanë të nevojshme një periudhë për veten e tyre të relaksohen dhe për këtë zgjedhin të shkojnë në vende të largëta ekzotike. Por kësaj radhe ka rastisur që reperët Noizy dhe Tayna të pushojnë në të njëjtën kohë në të njëjtin vend! Në rrjet flitet prej kohësh për një bashkëpunim të mundshëm mes Taynës dhe Noizyt dhe mund të themi se ku i dihet kjo nuk mund të jetë vetëm një dëshirë e fansave të të dyve, pasi një detaj na ka bërë të shpresojmë se mund t'i shohim bashkë në një duet dyshen në të ardhmen. Ishte Tayna ajo që na ngacmoi me një video që i kishin dërguar nga Phuket, Thailand dhe në sfond dëgjohej kënga e saj "KCE". Mirëpo e dini se në po të njëjtin vend ndodhet edhe reperi i njohur, Noizy. Të jetë Noizy 'përkrahësi sekret' i Taynas? Kjo nuk dihet, por nuk mund të jetë thjesht një koevidencë apo jo?



Isli Islami nuk ndalet! Dëshiron të provojë veten si aktor

Ai ka treguar me aftësitë e tij se është i zoti në moderim dhe përtej kësaj e kemi parë të eksperimentojë edhe në fusha të tjera. Ai ka treguar se është i aftë edhe në muzikë, madje ky ka qenë një pasion i hershëm për të. Por siç duket kjo nuk është e vetmja fushë ku dëshiron të eksperimentojë në botën e artit. Së fundmi Isli ka zbuluar për të gjithë ndjekësit në 'Instagram' se do të kishte shumë dëshirë të shfaqej në një film si aktor. Përmes aplikacionit pyetje-përgjigje, dikush është bërë kuriozë të dijë nëse ai e sheh veten si aktor filmash, madje në ato të 'Hollywood-it'. "Aaa më ke gjetur midenë. Më kanë thënë që kam plastikë shumë te mirë për aktor. Nuk e kam mbyllur asnjëherë atë derë, kështu që who knows. Pastaj në Hollywood më çove larg, edhe një Kinostudioje këtu s'do i kisha thënë jo", - ka thënë moderatori. Nuk do ishte keq ta shihnim Islin dhe si aktor apo jo?

Të jetë e vërtetë? Ndahen Ronela dhe Young Zerka!

Për vite me radhë dy këngëtarët janë përfolur për një lidhje mes tyre, por asnjëri nuk ka dashur ta pranojë. Ndërkaq, së fundmi Ronela Hajati dhe Young Zerka i kanë dhënë fund lidhjes së tyre. Çifti thuhet se i ka dhënë fund romancës për shkak të disa mosmarrëveshjeve që ata kanë pasur lidhur me mënyrën si e shihnin këtë lidhje. Edhe pse Ronela është shprehur se nuk ishte gati për bashkëjetesë, dëshironte të zyrtarizonte lidhjen e saj. Matje u përfol se kënga 'Vuj' ishte një dedikim kushtuar Zerkës. Ata për vite janë parë pranë njëri-tjetrit, por tashmë pas 4 vitesh dashurie të pa pohuar publikisht çifti i ka dhënë fund. Ata madje as nuk e ndjekin më njëri-tjetrin në rrjetet sociale. Por para se të themi janë ndarë, pikë së pari, të kenë qenë vërtet në një lidhje?



Vjen dasma e shumëpritur, Blero martohet në shtator me Afrona Dikën!

Prej muajsh përflitej për një dasmë të mundshme mes të dyve por së fundmi u konfirmua! Këngëtarë Blerim Muharremaj, i njohur si Blero ka konfirmuar për Gazetën Express se do të martohet në muajin shtator të këtij viti me modelen Afrona Dika. Pas pothuajse 1 dekadë kur ishte kurorëzuar për herë të parë me aktoren Teuta Krasniqi, pikërisht në muajin shtator dhe me të cilën ka edhe një vajzë, Blero pritet që të rikthehet në rendin e të martuarve në muajin e njëjtë.

"Mund ta konfirmoj se do të martohem në muajin shtator", ka thënë për Gazetën Express, Blero. Ai nuk ka dashur të specifikojë datë, por më shumë gjasë ajo do të jetë dita e fundit e verës 2019. Blero ka disa vite që është në tregun e beqarëve derisa në lidhje me modelen Afrona Dika është që nga viti 2015. Lidhja me Afronën kishte ardhur disa muaj pasi që ai i kishte dhënë fund martesës me Teutën, e cila tashmë është martuar me Adonis Morinën, një trajner fitnesi me të cilën ajo ka edhe një vajzë. Mezi presim të shohim bukuroshen Afrona në fustanin e nusërisë.



Realizon ëndrrën e fëmijërisë, Bebe Rexha takon idhujt e viteve '90

Para dy ditësh Bebe Rexha arriti të rrëmbente një çmim mjaft të rëndësishëm në eventin e "iHeartRadio Music Awards". Mes emrave të tjerë të njohur, Bebe Rexha u shpall fituese në kategorinë "Kënga më mirë e muzikës country" me "Meant to be" në bashkëpunim me Florida Georgia Line. Pasi mori trofeun, Bebe u shfaq shumë e lumtur për këtë arritje të radhës në karrierën e saj. Përveç kësaj ajo pati mundësinë të takonte një nga grupet më të njohur dhe të dëgjuar të viteve '90, Backstreet Boys. Këngëtarja publikoi në "Instagram" një video, në të cilën shihet tejet e entuziazmuar që pati fatin të njihje nga afër me djemtë e grupit. "Sinqerisht njerëzit më të mirë që kam takuar. Sikur Bebe e re ta dinte që do i ndodhte kjo gjë një ditë. Meqë ra fjala dështova keq", – ka shkruar këngëtarja në postimin e saj. Backstreet Boys janë ndër grupet më të njohura që vazhdojnë ende dhe dje, pas më shumë se 20 vitesh, të korin sukses njësoj si ditën e parë. Ndërkohë kujtojmë se një vit më parë Bebe Rexha fitoi një tjetër çmim në "iHeartRadio Music Awards" me po të njëjtin këngë.



"Mund të kishte vepruar ndryshe", Olta Boka në sherr me Kejsi Tolën?

Në puntatën e fundit të "Shiko kush luan", Kejsi Tola habiti me një përgjigje të dhënë ndaj pyetjes së bërë se cila është ajo këngëtare shqiptare, që sado që mundohet, nuk i ndrin ylli. "Olta Boka," tha shkurtimisht Kejsi. Por nga ana tjetër, Olta Boka duket paksa "e zhgënjyer" nga deklaratat e shoqes së saj. Nisur nga fakti që këngëtarët janë mike, një pjesë e mirë e kuptoi që ajo përdori emrin e Oltës sa për të dalë sa situata. Në intervistën e "Thumb", duket se Olta e ka mirëkuptuar zgjedhjen e saj, ndonëse do të kishte preferuar që Kejsi të vepronte ndryshe. "Absolutisht që e kuptova. Por mund ta kishte justifikuar alternativën e vetë duke thënë: 'Ej shiko se do të më kuptojë ajo.'" – shprehet Olta. Të këtë ndonjë çarje mes mikeshave?



Jo vetëm balerin, por edhe prezantues! Ja ku do e shohim së shpejti Graciano Taganin

Ai u largua prej kohësh tashmë nga trupa e baletit të "Albi Nako Dance" në Tv Klan. Tashmë duket se për Graciano Taganin karriera e tij do të vijojë në një tjetër anë, atë të moderimit. Edhe pse nuk bëhet fjalë për një program tërësisht të tijin, Tagani do të ketë një rubrikë në emisionin "Mos i fol shoferit" në Tv Klan, që do të quhet "Dance With Graciano". Ashtu siç mund të kuptohet, në qendër të kësaj rubrike do të jetë ajo çka Graciano di të bëjë më së miri, baleti. Duket se balerini do të ketë të ftuar VIP në studion e tij, që sigurisht nuk mund të ishte tjetër, përveçse një palestër baleti, ku krahas numrave të baletit ai zhvillon edhe një bisedë me personazhin e ftuar. Një risi e veçantë për të apo jo? Të shohim si do të shfaqet Graciano në rolin e ri të moderimit.

Opinioni *i* Ditës

Në dorë të popullit opozitar

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

...godinës së Kryeministrit në orën 11. Do të ketë shkatërrime objektsh (kërpudha dekorative nuk mund të konsiderohet objekt)? Nëse "më të zellshmit" do të provojnë të shpërthejnë kordonin policor, do të ketë gaz lotsjellës, si më 16 shkurt? Apo edhe më shumë? Opozita duket se do të qëndrojë në shesh shumë se sa qëndroi atëherë. Pra, më shumë se sa pesë orë. Ç'do të bëjë? Ka në plan të hapë një çadër tjetër? (Në fakt, për këtë shumica të përgjigjen: si zor). Megjithatë, paqartësitë janë të gjitha aty. Njëllor si 30 ditë më parë. Dhe gati po njëllor si atëherë, nuk dihet se sa (anti)paqësore do të jetë kjo protestë e madhe. Do të mjaftohet me parakalimin e turmës me pankarta? Apo nga turma, sidomos nga ajo më e revoltuara dhe e vendosura të bëjë dëm, do të kërkohet diçka tjetër? Me gjithë këto paqartësi, te qytetarët mbizotëron mendimi se sërish, sot shqetësimin kryesor opozita (por jo vetëm ajo, edhe pozita, ndoshta edhe ndërkombëtarët) nuk e ka tek fjalët që drejtuesit e saj do të thonë. Ato dihen. Janë artikullar prej kohësh tashmë. As edhe tek thirrjet që do t'u drejtojnë njerëzve. As edhe tek programi i veprimit të ardhshëm politik që do të shpalosë (nëse e shpalos). Jo. Aspak. Shqetësimi bazë, njëllor si edhe më 16 shkurt 2019, është vetëm një: numri i qytetarëve në rrugë. Do të jetë ai më i madh se sa një muaj më parë? Mendoj se po. Veprimi i tejskajshëm duhet t'i ketë galvanizuar jo vetëm përkrahësit e opozitës, por edhe mjaft të pakënaqur me qeverisjen e sotme. Por kryepytja është diçka tjetër, për të cilën opozita ndërhet fare e pasigurt, edhe pse kërkon në publik të duket e sigurt për të kundërtën. Kryepytja është: a janë të pakënaqurit më shumë se gjysma e atyre që votojnë të ne? Në çdo vend tjetër të qëndrueshëm demokratik të botës, nëse sondazhet e tregojnë këtë, opozita përpqet me çdo mënyrë paqësore (e theksoj, paqësore) të provokojë zgjedhje të jashtëzakonshme. Po, opozita jonë në rrugë? Ajo ndodhet në udhëkryq. Pas veprimit më radikal (shumë i rrallë, gati unik) në një situatë paqësore të një vendi demokratik, atij të mohimit të vullnetshëm të së drejtës për përfaqësim të votuesve të saj në parlament, opozita jonë nuk e di vërtet se çfarë të bëjë. E tunduar mes veprimeve jo dhe aq paqësore (djegje gomash, thyerje xhamash kryeministore, hedhje shashkash dhe shishesh molotov, etj.), që mund të ndezin një spirale dhune dhe mes fjalimeve të forta që karikojnë shumë pak dhe zgjasin akoma dhe më pak kohë.



Kryepytja është: a janë të pakënaqurit më shumë se gjysma e atyre që votojnë të ne? Në çdo vend tjetër të qëndrueshëm demokratik të botës, nëse sondazhet e tregojnë këtë, opozita përpqet me çdo mënyrë paqësore (e theksoj, paqësore) të provokojë zgjedhje të jashtëzakonshme. Po, opozita jonë në rrugë? Ajo ndodhet në udhëkryq. Pas veprimit më radikal (shumë i rrallë, gati unik) në një situatë paqësore të një vendi demokratik, atij të mohimit të vullnetshëm të së drejtës për përfaqësim të votuesve të saj në parlament, opozita jonë nuk e di vërtet se çfarë të bëjë. E tunduar mes veprimeve jo dhe aq paqësore (djegje gomash, thyerje xhamash kryeministore, hedhje shashkash dhe shishesh molotov, etj.), që mund të ndezin një spirale dhune dhe mes fjalimeve të forta që karikojnë shumë pak dhe zgjasin akoma dhe më pak kohë.

vendit, korrupsionit galopant, kapjes së shtetit në çdo qindarkë të parave të taksapaguesve (që të gjitha arsye të drejta) do t'i duhej një hap fals i pozitës, i shumicës qeverisëse. Një tejkalim në përdorimin e forcës për të mbrojtur institucionet nga turma e revoltuar (mos e dhëntë Zoti një viktimit)! Por të paktën një të plagosur fort për ta bërë hero. Mirëpo me këtë ministër të Brendshëm profesionist, të ardhur nga një akademi ushtarake gjermane, si zor që të presë një "dhuratë" të tillë nga pozita. Mbështetja nga ndërkombëtarët

për opozitën u pa se është e pakët, në mos gati zero. Kjo rrit pasigurinë dhe paqartësinë në radhët e saj ("Ku po shkojmë? Askush në Perëndim nuk po na jep të drejtë"). Opozita reale e vendit sot ka vetëm një aleat, popullin opozitar. Njëpërmjet pjesëmarrjes masive të këtij populli opozitar, opozita shpreson të kthejë në favor të saj ndërkombëtarët. Në mos të gjitha palët, të paktën partitë e djathta evropiane. Vetëm populli opozitar mund t'i japë asaj karburantin, kurajën e duhur për të vazhduar në këtë rrugë fare të pasigurt dhe me

njëmijë të panjohura. Si qytetare, urojmë që pjesëmarrja (duke përjashtuar aktet e dhunës) të jetë e madhe dhe të shërbejë si një mësim dhe pësim për qeverinë tonë, që ta mbajë atë të përgjegjshme për mënyrën se si na qeveris. Dështimi i protestës do të ishte karburant për shtimin e arrogancës së saj. Dhe mes të gjitha defekteve të sotme të qeverisjes, kapjes së shtetit, butaforisë dhe populizmit të skajshëm të saj, edhe një arrogancë e rritur e atyre që kemi mbi krye na duhet!

HOROSKOPI

DASHI
Të lindurit e kësaj shenje nuk këshillohen të ndërmarrin ndonjë udhëtim të lodhshëm gjatë kësaj dite, pasi mund t'ju shkatërron ditë e pushimit. Rekomandohet të vizitoni ndonjë mik ose të dilni me kolegët. Bëni kujdes me alkoolin nëse dilni në mbrëmje.

DEMI
Demët mund të përfshihen në disa situata argëtuese ose mund të marrin pjesë në ndonjë aventurë. Kjo e shtunë ka të gjitha shanset për të shkuar mirë. Në mbrëmje do të krijohet një situatë mjaft e këndshme me plot të qeshura.

BINJAKET
Binjakët mund të mërziten për shkak të disa ngjarjeve të papritura më 16 Mars. Dilemat mund t'i kaloni duke u treguar fleksibël. Përshtatuni me rrethanat dhe në vend që të bëheni pesimist, përpqini të gjeni mënyrat për të shijuar ditën.

GAFORJA
Disa Gaforre mund t'i vendosin një qëllim të ri vetes. Në përgjithësi, kjo e shtunë do të kalojë pa probleme. Do të jetë një ditë e përshatshme për udhëtime të shkurtra dhe takime me miqtë tuaj të ngushtë.

LUANI
Krenaria juaj këtë të shtunë do të jetë e tepruar. Kjo patjetër që do të lëndojë njerëzit përreth jush nëse e shfaqni gjatë bisedave. Do të ishte mirë të shmangnit ambicien për disa kohë. Shpenzoni të shtunën ashtu sikurse jua kërkon shpirti.

VIRGJERESHA
Të lindurit e kësaj shenje mund të relaksohen sot me rrethën e jetës. Bëni kujdes me shëndetin. Është e rëndësishme të flini aq sa jua kërkon trupi. Kushtojini vëmendjen e duhur partneres/partnerin për të kaluar një mbrëmje sa më të këndshme.

PESHORJA
Disa ngjarje gjatë kësaj dite mund t'ju irritojnë. Ka gjasa të krahasoni veten me dikë më të suksesshëm. Megjithatë kjo nuk është një arsye për t'u mërzitur. Shpenzoni këtë të shtunë nën shoqëri të mirë dhe mendoni rreth mënyrave për të shënuar fitore.

AKREPI
Për Peshoret parashikohet një ditë e mirë. Rrezikoni të humbisni disa gjëra të rëndësishme teksa ndihmoni të tjerët. Mund të zhvilloni një bisedë të rëndësishme me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj. Është dita e duhur për udhëtime të shkurtra.

SHIGJETARI
Dita juaj nuk do të jetë ashtu sikurse e prisnit për shkak të një shqetësimi. Fëmijët do të kërkojnë vëmendjen tuaj. Është e rëndësishme t'i përkushtoheni marrëdhënies në çift, mbi të gjitha ata shigjetarë që janë treguar indiferentë kohë e fundit.

BRICJAPI
Gjatë kësaj të shtune nuk pritni ndonjë surprizë emocionuese. Nëse nuk do të keni dëshirë të përfshihen në aktivitete argëtuese, rekomandohet të mendoni rreth projektit aktual në zyrë ose ideve rreth një biznesi të mundshëm. Në mbrëmje mund t'ju vizitojë dikush që keni kohë pa e parë.

UJORI
Rekomandohet të mos veproni nëse përfshihen nga emocionet. Pra se të ndryshoni diçka në qeshitje tuaja personale apo profesionale, bëni mirë që t'i merrni parasysh të gjitha pasojat. Përpqini të shmangni personat që kanë shfaqur xhelozsi ndaj jush.

PESHQIT
Peshqit do të kalojnë një ditë pa probleme. Flisni hapur me familjarët, pasi kjo do t'ju ndihmojë për gjendjen tuaj psikologjike. Do të ishte mirë ta pranoni një fessë që mund t'ju vijë në mbrëmje dhe përpqini të shijoni çdo moment.

Ish-trajneri i Partizanit vesh tutat

Starova nis stërvitjen me Laçin: Realizon objektivat

Sulejman Starova ka spranuar me vendosmëri një sfidë të re në karrierën e tij. Tekniku me shumë përvojë, nuk ka hezituar, duke i thënë "po" kërkesës së drejtuesve të Laçit, për të qenë trajneri i skuadrës kurbinase pas largimit të Prengës. "Kthehem pas një viti në Superiore dhe në radhë të parë falënderoj presidentin që më bëri ofertën. Kjo tregon se ai ka besim te unë dhe jam i obliguar të punoj me



përkushtim dhe të bëj maksimumin bashkë me skuadrën, për të realizuar objektivat e klubit",-tha

Starova. Cila është rruga për t'iu rikthyer paraqitjeve pozitive?! Në këtë drejtim Starova nuk shkruan një ekuacion të ndërlikuar në tabelë, është e thjeshtë...duhet fitorja me Flamurtarin të dielën. "Kemi një ndeshje me Fla-

murtarin në shtëpi dhe përgjigjen duhet që skuadra ta japë menjëherë në fushë, duke dhënë maksimumin. Për rezultatin, do të mendojmë ne si staf teknik. Një rezultat pozitiv do të jetë një motiv më tepër për të punu-

ar më i qetë në vijim. Superliga është shumë e fortë dhe mes skuadrave ka një diferencë shumë të vogël, ndaj çdo ndeshje është e luftuar dhe konkurruese, ndaj rezultatin e di zoti, jo ne",-deklaroi trajneri i ri i Laçit.

Champions League përcakton çerekfinale, Ajaksi për bardhezinjtë, Porto për skuadrën e Klopit

TRAJNERI I JUNAJTIDIT

Solskjaer: Barcelona? I dua këto përballje

Ole Gunar Solskjaer nuk është një nga ata që u trembet sfidave. Ish-sulmuesi i Manchester Junajtid, autor i atij goli historik në finale në vitin 1999 kundër Bajernit të Mynihut, tani kërkon të udhëheqë "djajtë e kuq" si trajner. Barcelona është skuadra përballë rrugës së tij, skuadër e dalë nga shorti i çerek-finaleve të Championsit, short të cilin Ole e komenton: "I duam ndeshjet e këtij lloji, kundër klubeve dhe skuadrave të mëdha. Kemi luajtur dy finale kundër tyre në 2009 dhe 2011, dhe një gjysmëfinale në 2008, këto janë ndeshjet që të gjithë tifozët duan, mezi po presim ditën e ndeshjes. Me shumë mundësi unë jam ndryshe nga pjesa tjetër e trajnerëve, sepse preferoj që ndeshjen e parë ta luaj në shtëpi dhe më pas në ndeshjen e dytë jashtë fushe të luaj për gjithçka, njësoj si me Parisin",-tha Solskjaer.

por Junajtid-Barcelona. Tifozët mund të pyesin se përse UEFA nuk ndryshoi shortin e Totenhem-Mançester Siti, por atë të Barcelona-Mançester Junajtid, por drejtori i turneve në Nion, Xhorxho Marketi, pati theksuar që në krye të herës se ky spostim do t'i ndodhte ekipit të dytë në short.

Shorti, kënaqet Juvja e Liverpooli derbi britanik dhe Barça-Junajtid

Siti i Guardiols do të përballlet me Totenhemin



Jeton Selimi

E gjithë bota e futbollit kishte kthyer vështrimin nga Zvicra, aty ku në Nion u hodh shorti i fazës çerekfinale në Champions League. Format i "veshë të mëdhenj" këtë sezon ishte ndryshe, nuk kishte asnjë pengesë, çdo skuadër mund të përballlej ndërmjet tyre, për më tepër që ekipet do të mësonin fatin deri në finalen e madhe të Madridit. Si rrallë herë, goglat nuk sollën asnjë përballje titanësh, mbase përjashtim mund të bëjë pak Barcelona-Man. Junajtid, e vetmja sfidë që rezervon emocione, pjesa tjetër e shortit dukej sikur ishte e projektuar sipas preferencave të ekipeve të mëdha. Të gjithë tifozët shprehonin në një përballje Barcelona-Juventus, në mënyrë që të shihnin edhe një herë përballje të tyre Lionel Mesin dhe Kristiano Ronaldon, një përballje e cila mund të ndodhte vetëm në finalen e madhe. "Zonja e Vjetër" mund të buzëqesh pasi shorti i rezervoi "vogëlushët" e Ajaksit,



fundja shmangën të gjithë ekipet britanike dhe mbi të gjitha Barcelonën. Holandezët vijjnë me moralin në maksimum pasi eliminuan kampionët në fuqi të Real

CHAMPIONS LEAGUE
ÇEREKFINALET
 Ajaks - Juventus
 Totenham - Siti
 Liverpool - Porto
 Barcelona - Junajtid

Madrid. Një short pozitiv edhe për Liverpool tekso përballë në fazën çerekfinale do të kenë Porton. Derbi i vetëm britanik që prodhoi shorti ishte Totenham-Man Siti. Fituesi i këtij çifti do të përballlet në gjysmëfinale me fituesin e çiftit Ajax-Juventus. Fituesi i çiftit Barcelona-Man. Junajtid do të përballlet me fituesin e çiftit Liverpool-Porto. Ndeshjet e para të fazës çerekfinale do të luhen me 9 dhe 10 prill ndërsa ndeshjet e kthimit më 16 dhe 17 prill. Sfidat e para gjysm-

finale do të luhen me 30 prill dhe 1 maj ndërsa ato të kthimit më 7 dhe 8 maj. Finalja e madhe do të zhvillohet më 1 qershor në Madrid, në Estadio Metropolitan. I vetmi rregull i vendosur nga UEFA kishte të bënte me dy klubet nga Mançesteri, Junajtidin dhe Sitin, të cilat nuk mund të luajnë kurrësi në të njëjtën ditë në qytet nëse nuk do të luajnë me njëra-tjetrën. Pra, përpara fillimit të shortit, u përcaktua se do të kishte ndryshim të tij nëse kjo gjë do të ndodhte. Ndaj, UEFA ka ndërhyrë për të ndryshuar shortin e sfidës Barcelona-Mançester Junajtid, që goglat e përcaktuan sfidën e parë në Katalonjë dhe të kthimit në Mançester, njëjtë si edhe Siti. Kështu, ndeshja nuk do të jetë më Barcelona-Junajtid,

DREJTUESI I JUVENTUSIT

Nedved: Kujdes Ajaksin, nuk duhet nënvlerësuar

Pavel Nedved beson se Ajaksi është një skuadër që nuk duhet marrë kursesi me lehtësi, pasi mund të bëjë dëm sikundër tregoi dhe ndaj Realit të Madridit. "Nuk jam as i kënaqur nga shorti, por nuk jam as i pakënaqur, besoj se do të jenë dy ndeshje të bukura. Ajaksi ka treguar se e meriton të jetë në këtë situatë, kanë eliminuar Realin e Madridit dhe kjo nuk është shaka. Duhet të jemi të fokusuar". Në mediat spanjolle është aluduar për një dënim të Kristiano Ronaldos për shkak të gjestit të "huevos" të bërë në fund të ndeshjes kundër Atletikos, por Nedved është i qetë. "Nuk



i druham skualifikimit të Ronaldos, gjesti ka mbetur në fushë dhe në emocionet e pas ndeshjes mund të tolerohet. Pati një shfryrje pasi u ofendua gjithë kohën nga tifozët e Atletikos. Nuk mendoj se do të ketë sanksione". Dy fjalë dhe për çështjen e trajnerit, me Alegrin që përflitet se do të thotë lam-

tumirën në fund të sezonit. "Presidenti dhe trajneri do të takohen në qershor dhe do të flasim për të ardhmen. Ajo çfarë Alegrin po bën është e jashtëzakonshme, në kampionat nuk kishte ndodhur më parë të kishim 18 pikë diferencë nga vendi i dytë, nuk mund t'i kërkojmë më shumë."

EUROPA LEAGUE

Napoli-Arsenal, finalja e parakohshme e turneut


Shorti i pamëshirshëm spër Napolin e Karlo Ancelottit në çerekfinale të Europa League. Të kaltrit në këtë raund do të kenë përballë Napolin në një finale të parakohshme për këtë kompeticion. Me shumë fat Çelsi që sërish nuk do të ketë një rival të denjë për t'u përballur as në këtë fazë. Blutë e Londrës do të sfidojnë surprizën që mban emrin e Slavia së Pragës dhe që në 1/8 nxori jashtë mbretëreshën e Europa League, spanjollët e Sevilljes. Nuk mund të mungonte një derbi në këtë raund dhe do të jetë ai i komunitetit Valencian, pasi Vijareali do



EUROPA LEAGUE
ÇEREKFINALET
 Napoli - Arsenal
 Vijareal - Valencia
 Çelsi - Slavia
 Benfika - Frankfurt

fituesja e çiftit Arsenal-Napoli do të përballlet me të kualifikuarën nga derbi spanjoll Vijareal-Valencia, ndërkohë që Çelsi, nëse kalon çekët e Slavia së Pragës, do të masë forcat me fituesin e çiftit Benfika-Frankfurt. Ndeshjet e para të fazës çerekfinale do të luhen më 11 prill ndërsa ato të kthimit një javë më vonë në datën 18 prill.

Fjalëkryqi (1)



- HORIZONTAL**
- Bëjnë arte me re.
 - Krijoi Arsene Lupin (inic).
 - Janë forma.
 - Në hyrje të plazhit.
 - Kapen të parat.
 - Janë ufot.
 - Mbahen nga ata që i thyejnë.
 - Inicialet e Mascagni-t.
 - Në krye të trupave.
 - Eshtë edhe ai i Këngëve dhe valleve.
 - Pak hemorragji.
 - U shkrua nga Jack London.
 - Institucione Ndërkombëtare Europiane.
 - Scarlet e Bashkë me erën.
 - Janë tituj në ekran.
 - Eric aktor.
 - Kështu e ka syrin vigjilent
 - Janë nofka.
 - Një provë... inteligjence.
 - Mund të jenë me sahat.
 - Një pjesë e naivitetit.

- Pak imagjinatë.
- Pikat pa kufij
- Fillojnë aksionin.
- Kërkohej nga poetët.
- Nota e diapazonit.
- I prin kolonës.
- Eshtë filozofie moralit.
- Ulet në dhomën e lartë.

VERTIKAL

- Malet pa kufij.
- Janë banorë imagjinarë të planetit të kuq.
- Inicialet e Altman.
- Një sportist që arrin majat
- Courier ish-kampion i tenisit.
- Fillojnë testin.
- Mund të jetë parabolike.
- Bie me ballë.
- Camera, ish-kampion i ringut.
- Lidhet mes punëtorit dhe punëdhënësit
- I kanë rrënjët në tokë.
- Eshtë pushkë.
- Brown i Kodi i Da Vinci-t.
- Takim Brezash Durrës.
- Ishte lumi i Elizit
- Eshtë kardinal.
- Mbyllin një krah.
- Artikull anglez.
- Mbyllin fushatat.
- Partia pa ara.
- Zola që shkroi Nana
- Nganjëherë duhen vënë mbi i.
- Një fjalë kastile
- Inicialet e Mann shkrimtar.
- Maiden që këndojnë.
- Ai i shtatë është kinemaja.
- Fillojnë arsyetimin.
- Eshtë nënë e Tironës.
- Eshtë shahu i fundit.
- Inicialet e Klee piktor.
- Dy asa.
- Mbarojnë fare

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL:

- Patricia këngëtare.
- I vocërr ai i Migjenit
- Hari spiune.
- Qyteti i Robespierre.
- Phineas i famshëm i cirkut.
- Pak latinisht.
- Inicilet e Banderas.
- Janë tek në rrota.
- Pak efikasitet.
- Eshtë shkolla fillore.
- Arrihet duke aderuar
- Pak iniciativë.
- Një... art i Don Judd.
- U kompozua nga Rachmaninov.
- Diku në qendër.
- Një është për të lidhur.
- Jepet për hartim.
- Sergej, poet i famshëm rus.
- Veriu pa kufij.


- Mbyllin një tender.
- Një pjesë analogjisë.
- Mjeku pa ju.
- Nisin nga kreu.
- Një racë kombi.
- Një rapper i famshëm.
- Një pikë... vaj.
- Në fund majtas.
- Ndizen me një çelës.
- Emri i Delon
- Janë të dërguar specialë

VERTIKAL


- Eshtë edhe ai i sheqerit.
- Eshtë lloj papagalli.
- Një Pop i Andy Warhol.
- Sapo fillojnë.
- Qendër në Kubë.
- Eshtë pluhuri si Dash.
- Eshtë e hollë dhe therëse.
- Fillojnë muzikën.
- Një kontinent i ri.
- Eshtë për medaljen e parë.
- Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj per-sëve.
- Provinca e boerëve.
- Eshtë qyteti i njëmbinjë dritareve.
- Eshtë dukuria.
- Eshtë hidrokarbur.
- Griffith aktore.
- Qe perëndesha e fitores.
- Mbeten në fund.
- Tregon çmimin.
- Këndohet në opera.
- Para Fe në New Mexico.
- Eshtë princ arab.
- Tony që këndon Quando, quando, quando.
- Bën mëza.
- Pak tolerantë.
- Modem pa zë.
- Pak marramendëse.
- Mbyllin një dyqan.
- Fillojnë teorikisht.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

6	5					3	1	
		3		2				
				8		9		
2	6		7					
	4				1			
					3	7	9	
			5	9	7		8	1
		5					2	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

5	7	4	3	1	6	2	8	9
8	6	9	2	7	4	3	5	1
1	3	2	8	5	9	4	6	7
2	8	5	9	4	7	1	3	6
7	4	1	5	6	3	8	9	2
6	9	3	1	8	2	7	4	5
3	5	6	4	2	1	9	7	8
4	1	7	6	9	8	5	2	3
9	2	8	7	3	5	6	1	4

Argëtim filozofik

- Problemi i vetëm kur nuk keni të bëni asgjë, është që nuk mund të ndaleni për të pushuar.

*- Budallai që ecën, është me më shumë vlerë se dhjetë intelektualë që rrinë.

*- Kurrë mos ndalo të buzëqeshësh, edhe kur nuk jeni të lumtur. Dikush mund të bie në dashuri me buzëqeshjen tuaj.

*- Të jesh ai që je dhe të thuash atë që ndien, sepse ata që japin rëndësi nuk kanë rëndësi dhe ata që kanë rëndësi nuk japin rëndësi.

- Sepse thjesht disa njerëz janë kaq shumë të veçantë, ta vlen të jetosh, vetëm dhe vetëm për t'i takuar, dikur ...

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

4	1	9	2	10	19	6	5	4	5	3		19	B	A	S	T	E	T	P	A	P	A			
6	4	1	3		11					3	7	4	R	U	14	P	U	R	A	H	P	A			
13		4		3	2	4	3	2	4	5	3		S	A	M	M	M	A	R	A	I	N	I		
7	2	9	5	4	6	5	4	5	3		18		T	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T		
13	5	11	6	4	5	10	3	5	3		14	4		P	R	O	T	E	S	T	A	N	T	E	T
19		3	2	16	1	4			2	3	2		G	J	I	G	A	N	T	I	I	R	R		
7	4	6	14	5		2			1	11	5		B	E	T	O	N	E	K	B	O	A	T		
8	11	1		6	11	14		4	2	18	11		S	A	L	I	R	A	M	A		E			
3	2	10	3	2	11	6		18	4	4	2		G	O	N	T	I	T	U	L	L	A	R		
18	8		4	5	7	6	14	6		3	5		A	R	E	S	A	O			E	N	E		
15	2	3	2	11		2	11	6	5	10	5	3		Z	J	A	R	Z	O	T	I	M	E	T	
5	3	2	14	2	3		7	2	3	5	3	6		I	A	M	E	R	E	N	G	U	E	S	

- Trishtimi i tepërt qesh. Gëzimi i tepruar qan.

- Të gjithë jetojmë nën të njëjtin qiell, por jo të gjithë kemi të njëjtin horizont.

- Mos zgjidhni një rrugë pa pengesa, me siguri nuk do të të çojë askund.

- Vetëm ai që beson është i bindur dhe vetëm ai që bindet beson.

- Çfarë është e vërteta? Për shumicën, është ajo që lexon dhe dëgjon vazhdimisht.

- Kur një njeri të shkakton zemërim, do të thotë se ai është më i fortë se ti.

Thënie të mënçura

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

R R E S F D E T I
M A M A M M E P K E L
A M I S I M O N I A B O
T O T R E T O R I K A
E N O K D O M A T E L
R M A R T I R E T T O
I A R A T O N E E R R
A N M Q I L A R R O D
L A D M A L I A
E N T E V E A P L R
A R M A N I A N D E
T E R R I T O R I A L E M

FJALËKRYQI (2)

K L A S A S P A R T A K U
K A R R I E R A A R T
M E R C E N A R O
G J A H U N I N J A
J I T U G S U M O
L E E E T O P A R
F I A T M S B R O T A
R M R S A M O T E R O
O B E R O N M I A
N I N A M A T H A U
T A S T I R O I D E T
I N T E R I M M K E N

